

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 24940126

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data: / Datum: 15.06.2026

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 101/26 15/06/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 qershor 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 maj 2026;
2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;
3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;
4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
5. Draft-Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë;
6. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01. Nr. PB-90/26 25/06/2026

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 28 MAJ 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në ora 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë si: Behar Duraku, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Melihate Basholli – Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Hava Mlinaku, Pëllumb Maliqi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Berat Sadiku, Betim Grabanica, Mek Selaci, Leonora Gërguri dhe Gresa Muli.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari Komunës z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhergrova, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 26 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- përshëndetje për të gjithë. I nderuari Kryetar i komunës, i nderuar nënkryetarë, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it, të mediave, të shoqërisë civile, përfaqësues të MAPL-së, shumë të nderuar qytetarë të komunës së Vushtrrisë, jemi në seancën e rregullt të muajit maj. Fillimisht më lejoni që të gjithë ju që jeni të pranishëm këtu dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë t'ju uroj festën e Kurban Bajramit. Në ndërkohë konstatoj që të pranishëm në sallë jemi 25 anëtarë të kuvendit, gjashtë të tjerë mungojnë, dy prej tyre më kanë njoftuar që nuk marrin pjesë, është Mek Selaci edhe Berat Sadiku, të tjerët po besoj që në ndërkohë vijnë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, sigurisht e keni marrë edhe materialin pas Komitetit për Politikë e Financa që i patëm dy pika shtesë, i shqyrtuam dhe i aprovuam në Komitetin për Politikë dhe Financa. Përndryshe ndryshime të tjera nuk kemi në

rend të ditës. Megjithatë fillimisht hapi diskutimin para rendit të ditës.

Ferit Idrizi- kryetar i komunës- I nderuar nënkryetar, qeveri komunale, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të mediave, të KFOR-it, të shoqërisë civile, të gjithë të pranishëm. Të dashur qytetarë të Vushtrisë. Meqë jemi në ditën e dytë të festës së Kurban Bajramit, fillimisht më lejoni që juve anëtarë të kuvendit, të gjithëve t'ju uroj festën e Kurban Bajramit dhe po ashtu edhe qytetarëve të Vushtrisë. Gjithashtu ju uroj edhe dy anëtarëve të kuvendit të cilët i kemi në haxh, e kemi Berat Sadikun edhe Mek Selacin. Ju dëshiroj qëndrim të mirë atje, shëndet dhe pranim të haxhit. Faleminderit të gjithëve. Edhe kjo, është seancë me pak pika të rendit të ditës. Shpresoj që do t'i procedojmë bashkarisht të gjitha.

Vlerë Tahiri- anëtare e kuvendit- përshëndetje të nderuar të pranishëm, qytetarë të dashur. E shoh se në rendin e ditës në pikën e pestë është raporti i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në vitin 2025. Mirëpo shumë shpesh qytetarët më kanë kontaktuar edhe më kanë pyet se çfarë u bë me të njëjtin raport që është dalë në vitin 2023, në qershor të vitit 2023. Siç e dimë në raportin bëhet prej drejtorisë së emergjencave, dërgohet në AME, AME-ja e dërgon në qeveri edhe prej atje komisioni i qeverisë i pranon ose nuk i pranon. Raportin e po atij viti, komisioni i qeverisë e ka pranuar edhe e ka nxjerrë një vendim i cili asnjëherë nuk u ardh në zyrat e komunës, mirëpo është konfirmuar përmes telefonit me zyrtarët e drejtorisë përkatëse. Qytetarët duke pasqyruar se ju kanë premtuar kompensim për ato dëme, qytetarët kanë marrë edhe kredi dhe janë dëmtuar financiarisht, mirëpo dëmet asnjëherë s'janë kompensuar. Po kërkoj përmes kryetarit të komunës që të dërgohet një email dhe të kërkojë prej institucioneve përkatëse në qeveri ose në ministri dhe të sqarohet për qytetarët se si është puna e këtyre raporteve të cilat siç është me rregull duhet me u kriju prej komunës, janë krijuar, janë pranuar në qeveri mirëpo atje po ngecë puna. Tani qytetarët për këtë raport të vitit 2025 nuk e kanë besimin që do të u kompensohen dëmet. Kështu kryetarit i lutem ta sqaroj edhe njëherë, ndoshta e sqaroni më mirë. Derisa komuna i ka kryer procedurat e saj, unë kërkoj që të bëhet më shumë presion sepse qytetari ynë është dëmtuar. Gjithashtu më duhet të theksoj se gjatë fushatës lokale është premtuar nga vetë ish-kryeministri në njërin nga fshatrat e Vushtrisë që këto dëme do të kompensohen. Dua që sot të merret një vendim për këtë çështje dhe dua që të na premtohet nga kryetari se do të bëhet presion te qeveria dhe tek institucionet përkatëse rreth kësaj çështje dhe qytetarët të kompensohen për dëmet.

Dritë Dibrani- anëtare e kuvendit- Pasi i përshëndeti të gjithë deklaroi: Përderisa secili prej nesh këtu i gëzohemi investimeve në sport, investime të cilat në qytetin tonë janë të mirëseardhura nga cilado qeveri që udhëheq vendin. Si përfaqësues e qytetarëve jam këtu për të ngritur zërin e disa shqetësimeve të drejtpërdrejta që kam pranuar nga terreni gjatë kësaj periudhe. E para ka të bëjë me punimet në sheshin e qytetit. Punimet po shkojnë tejte ngadalë dhe është e pakuptueshme sesi një projekt kaq vital për Vushtrinë, në terren nuk shihen më shumë se 4 apo 5 punëtorë duke punuar. Qytetarët dhe bizneset po përballen me zvarritje, andaj kërkoj nga menaxheri i kontratës të rris urgjentisht presionin mbi mbikëqyrjen. E dyta është siguria e fëmijëve tanë. Një pjesë e ulësve në formë tribune, ku është mbjellur barë dhe lule, fëmijët po ngjiten vazhdimisht për të luajtur. Është kërkesë e prindërve që aty të vendoset një rrjetë apo barrierë mbrojtëse me qëllim që të parandalohet ndonjë rrezik apo rast fatal nga pakujdesia. Çështja tjetër ka të bëjë me shqetësimet me hapësirat publike të cilat shfrytëzohen. Kam një pyetje konkrete lidhur me tarracat e banesave dhe lokaleve, si është e rregulluar kjo çështje me vendim zyrtar duke parë që po zihen trotualet dhe hapësirat e përbashkëta publike ku kalojnë edhe këmbësorët. Të nderuar kolegë, në mbledhjen e kaluar kam parashtruar disa pyetje specifike, burimet e të cilave janë raportet zyrtare dhe shqetësimet e qytetarëve që po përballemi me një injorim total dhe mosshikimin e përgjigjes nga

drejtoritë përkatëse. Për drejtorinë e urbanizmit dhe inspektoriatit. Në raportin e juaj figuron se janë dhënë 34 leje ndërtimi. Pyetja ime është e përsëritur drejtor. Sa është përqindja e hapësirave publike dhe zonave të gjelbërta që janë siguruar për qytetarët tanë përmes këtyre lejeve, apo po vazhdojmë vetëm me betonizim të egër?! Poashtu, kërkoj llogari se si po menaxhohet dhe si po ndodhin ndërtimet në tokat bujqësore. Gjithashtu te Drejtoria e Shëndetësisë, drejtori pati premtuar që publikisht do t'i sjellë emrat e anëtarëve të komisionit për hartimin e specifikave, komisionit të vlerësimit dhe atij të pranimi të pajisjeve laboratorike. Ende nuk i kam marrë këta emra. Çfarë po fshihet pas këtyre komisioneve që po hezitojnë të ndajnë të dhënat me ne? Kryetar dhe Drejtori e Urbanizmit kam një pyetje shumë specifike lidhur me programin për banimin e përballëueshëm social. Në cilën fazë të këtij programi gjendet komuna jonë, pasi që qytetarët dhe familjet në nevojë kanë të drejtë ta dinë saktësisht se ku jemi në këtë proces. Gjithashtu në mbledhjen e marsit, te çështja e raportit të auditorit, gjatë diskutimit që e kam pasur në kuvend në lidhje me zbatimin e rekomandimit të auditorit dhe mbrojtjen e parasë publike është konstatuar edhe një rast skandaloz. Një lokal në zemër të qytetit shfrytëzohet tash e shtatë vite pa paguar asnjë cent qiraje. Dëmi ka arritur 30.000 euro. Komuna nuk ka ndërmarrë asgjë për të inkasuar këtë borxh. Andaj si anëtare e kuvendit në emër të qytetarëve, kërkoj të na thuhet se për cilin lokal bëhet fjalë.

Diellza Pllana - anëtare e kuvendit- Pasi i përshëndeti të gjithë deklaroi: sot me shkas dua të diskutoj një çështje që prekë drejtpërdrejtë shumë të rinj të komunës sonë për bursat studentore. Shkaku i diskutimit është për shkak të vonesës së hapjes së konkursit për bursa këtë vit. Pa e nisur këtë diskutim duhet pranuar se gjatë qeverisjes së kryetarit Idrizi, janë bërë ndryshime shumë të mira në favor të të rinjve dhe përfituesve të kësaj skeme të bursave. Është rritur edhe shuma që këta studentë përfitojnë. Është rritur edhe numri i bursave. Për herë të parë studentë të Vushtrisë që studiojnë jashtë Kosovës marrin bursë pikërisht nga komuna e Vushtrisë. Fatkeqësisht deri para qeverisjes Idrizi, këta studentë nuk janë trajtuar siç duhet. Këto ndryshime tregojnë se ka pasur edhe reflektim edhe gatishmëri për ta përmirësuar skemën e atëhershme ekzistuese. Megjithatë pikërisht për shkak se janë bërë këta hapa pozitiv, besoj se duhet të kemi guximin të flasim edhe për problemet që kanë mbetur ende pa u zgjidhë. Një problem që duhet përmendur është hapja shumë e vonshme e këtij konkursi për bursa. Do doja shumë që sot të ishte prezente këtu drejtoresha e arsimit, është fundi i muajit maj, po hyjmë në muajin e gjashtë të vitit veçse ka përfunduar viti akademik 2025-2026, pikërisht në kohën kur studentëve iu kanë dashur këto të mira financiare prej komunës, këto nuk po jepen duke shtyer kështu ndarjen e kësaj mbështetje financiare për muajt e verës. Unë do doja shumë që edhe të dimë prej drejtoreshës pse ka ndodhur kjo vonesë këtë vit për shkak se viteve të kaluara ndonëse janë dhënë në pjesën e parë të vitit, është hapë konkursi shumë më herët. Këtë vit ka një vonesë që nuk e dimë për çka edhe a do të vazhdohet kjo praktikë edhe gjatë viteve të tjera, nëse po, do duhet gjithsesi të ndryshohet për shkak se e humb efektin e kësaj mbështetjeje financiare te studentët. Gjithashtu një tjetër problem i kësaj skeme ekzistuese të bursave është numri ende i kufizuar i bursave krahasuar me kërkesën reale të studentëve. Nga analizat që kam bërë rezulton se dhjetra studentë kanë mbetur jashtë skemës, jo vetëm për shkak të konkurrencës, por edhe për shkak se disa drejtime nuk janë përfshirë fare në konkurs. Kjo është ndjenjë zhgënjyëse për shumë studentë të juridikut, ekonomikut, edukimit, shkencave politike dhe fushave të tjera të cilët ndihen sikur puna dhe angazhimi i tyre nuk po vlerësohen prej komunës ose vlejnë më pak veç pse nuk janë drejtim deficitar. E kuptoj tërësisht praktikën e dhënies së bursave për këto drejtime deficitare që e ka bërë pikërisht qeverisja e zoti Idrizit, në mënyrë që ta orientoj studentin drejt këtyre drejtimeve, drejtimet që janë të nevojshme për Kosovën. Mirëpo, unë mendoj që edhe këta studentë të paktën në mënyrë simbolike duhet të përfshihen në këtë kategorinë e studentëve

që përfitojnë mbështetjen financiare prej komunës të paktën prej vitit të ardhshëm. Gjithashtu propozoj që qyshë nga ky vit për shkak se ende nuk është hapur konkursi dhe jemi në kohë. Në rezultatet e këtyre bursave të përfshihet edhe sistemi i pikëzimit me qëllim që secili kandidat të dijë qartë mënyrën se si është vlerësuar. Sa pikë ka marrë prej notës mesatare, sa prej kategorisë sociale që i takon, sa prej aktiviteteve ekstra kurrikulare që vlerësohen. Një mënyrë e tillë e shpalljeve të rezultateve e forcon besimin mes komunës edhe studentëve. Gjithashtu me të drejtë besoj që e ngrej edhe nevojën për zgjerimin e kategorive sociale ku kërkoj që të mbështeten familjet që kanë dy ose më shumë studentë duke i shtuar pikë këtyre studentëve që konkurojnë për këtë mbështetje financiare prej komunës. Praktikisht nuk ka ndodhur më herët në sistemin e bursave. Besoj se ndryshimet që i përmenda duhet të jenë veç fillimi i një reforme më të lehtë dhe sistemi gjithpërfshirës të bursave. Gjithashtu dëshiroj edhe të shpreh gatishmërinë time ndaj drejtoreshës së Arsimit që jam e gatshme dhe unë të kontribuoj si anëtare e këtij kuvendi për çdo ndryshim të mirë studentëve.

Fidan Bejta- anëtarë i kuvendit- Pasi i përshëndeti të gjithë deklaroi: E kam një kërkesë për kryetarin, për drejtorinë përkatëse. Punimet në stadium të qytetit po besoj që kanë me fillu shpejt. Uroj dhe besoj që me fillu shpejt. Edhe iu kemi gëzuar këtij lajmi pavarësisht kush e ka marrë primatin, kush e bën. Nuk kanë bërë mirë që nuk kanë ftuar kryetarin se është zot shtëpie. Ajo është çështje tjetër. Çfarë na mbetet neve është që ata djem që do të na përfaqësojnë në superligë kanë me mbetë për një kohë pa stadium. E jona mbetet rregullimi i kushteve për zhvillim të stërvitjeve pse jo edhe lojrave në fushën e Dobërllukes ku është stadiumi aktual. Andaj ky mund të jetë një problem i madh, i cili mund t'i kushtoj ekipit tonë shumë.

Ymer Haradinaj- anëtar i kuvendit- në fjalën hyrëse, pasi përshëndeti të pranishmit deklaroi: në seancat e kaluara i kam ngritur disa çështje për të cilat kam marrë përgjigje gjatë seancave, po që në terren nuk janë realizuar. E para ka qenë çështja e rregullimit të një rruge në fshatin Stanofc të Epërm, vendosja e disa gypave. Drejtori atë ditë më ka premtuar që do të rregullohet brenda javës. Drejtori është këtu, ende nuk ka asnjë lëvizje. Po ashtu i kam ngritur disa çështje që kanë të bëjnë me varrezat në Druar. E po ashtu gjatë asaj seance nënkryetari i komunës ka dhënë premtim që ajo çështje do të rregullohet, çështja e një kanalizimi atje, por ende nuk është bërë asgjë as nga nënkryetari as nga drejtoria përgjegjëse. E po ashtu dua të potencoj një çështje. Çështja e vizitës së kryeministrit. Unë i përgëzoj qytetarët e Vushtrrisë për investimet që po i bën qeveria në rregullimin e stadiumit. Kjo është një çështje shumë me vlerë. Janë afër 5 milion euro investime. Dua t'i tregoj kryetarit të komunës që kanë qenë shumë projekte në vitin 2025 të cilat kanë qenë bashkëfinancim i qeverisë të Kosovës, i ministrive përgjegjëse bashkë me komunën e Vushtrrisë. Kryetari i komunës ka prerë shirita pa pjesëmarrjen e ministrave dhe kryeministrit. Prandaj mos luani rolin e viktimës. Është e drejtë e kryeministrit. Ne veç i gëzohemi investimeve që vijnë nga qeveria e Kosovës.

Rrahim Ajeti- anëtar i kuvendit- Pasi përshëndeti të pranishmit deklaroi: Unë nuk kam replikë, por kam një pyetje për kryetarin dhe për ish-kryeministrin. Edhe unë, kam pranuar shumë pyetje nga qytetarët lidhur me premtimin për ndërtimin e rrethrotullimit të Varrezat e Dëshmorëve në Dumnicë. A do të realizohet ky projekt, apo do të ketë të njëjtin fat edhe projekti i stadiumit, i cili u përdor vetëm si premtim gjatë fushatës zgjedhore? Gjithashtu, një shqetësim tjetër që po ngritet vazhdimisht nga qytetarët ka të bëjë me segmentin rrugor nga rrethrotullimi deri te Emona. Ka paqartësi rreth institucionit përgjegjës për këtë rrugë; disa pretendojnë se është nën kompetencën e komunës, ndërsa të tjerë thonë se është nën përgjegjësinë e ministrisë. Prandaj, do të ishte e dobishme që kryetari të na sqarojë, si neve ashtu edhe qytetarëve, se cili institucion e ka në administrim dhe mirëmbajtje këtë rrugë. Gjatë fushatës zgjedhore shpeshherë fajësia i atribuohet

komunës, ndërkohë që ne kemi informacion se kjo rrugë është projekt dhe përgjegjësi e ministrisë. **Ferit Idrizi- kryetar i komunës-** tha se vërtetë çdo shqetësim që është me vend unë e mbështes. Sa i përket zvarritjes së punimeve në sheshin e qytetit është e vërtetë po gjithçka është lidhur me aspektin financiar. E kemi shpjeguar disa herë para qytetarëve të Vushtrrisë që jo vetëm sheshi por edhe shumë projekte nuk kemi mundur me i ndjek operatorët me pagesa. Arsye e kësaj është kontrata kolektive e mësimdhënësve që deri më tash përmbaruesi përmes gjykatës na i ka marrë 13.600.000 euro. Është një shumë e madhe e mjeteve. Të gjithë e dini se për një komunë si komuna e Vushtrrisë që buxhetin për investime kapitale për vitin 2025 e ka pasur 5.032.000€ dhe me i marrë kësaj komune 13.600.000€ 000 euro, është një goditje shumë e madhe financiare dhe jemi duke u përballë me sfida jashtëzakonisht të mëdha. Normalisht, kontratën kolektive që e ka nënshkruar Ministria e Arsimit e një qeverie është dashur me e përmbush qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk e ka përmbushur. Jemi në këtë situatë dhe pikërisht për këtë janë zvarritur punimet për asgjë tjetër. Pra ka qenë dashtë të shtyhet afati për përmbarimin e punimeve. Të njëjtë e kemi situatën edhe me tregun e gjelbërt, njëjtë e kemi situatën edhe në rrugën “Bekim Berisha”, të njëjtë e kemi situatën edhe me shumë e shumë projekte të tjera, por tash gradualisht jemi duke e marrë veten edhe kemi siguruar mjete për pagesë. Besoj fuqishëm që sheshi veç është në përfundim e sipër dhe do të përfundohet para se të vijë mergimtarët. Sa i përket sigurimit të atyre tribunave në shesh, do ta marr me shumë seriozitet këtë propozim tuajin, se të them të drejtën aty ka shumë shkurte edhe kurrë nuk kam menduar që hyjnë nxënësit. Por po iu them sinqerisht që vlera e këtij sheshi do të tregohet me kohë. Vetëm atë ditë që u luajt finalja në Gjakovë dhe atje nuk i kanë lejuar tifozët FORCA të shkojnë. Siç e di unë kam qenë vetëm 50 bileta, për atë e kemi vendosur një monitor edhe atë ditë kam thënë se me të vërtetë ia ka vlejtur investimi në shesh. Ia ka vlejtur investimi në shesh se u bë një atmosferë sikur me qenë në stadium. Për sa i përket se në cilën fazë ndodhet programi i përballimit social. Nga ana e komunës janë kryer të gjitha procedurat, ka mbetur vetëm të bëhet alokimi i mjeteve nga ana e ministrisë. Jemi në bashkëpunim me ministrinë në këtë drejtim dhe besoj që do të filloj së shpejti. E kemi pyetjen e Diellzës. Është e njëjta situatë me mjetet financiare sikurse përgjigja që i dhashë Dritës. Me të vërtetë në momentin e fundit na i kanë marrë mjetet financiare dhe nuk kemi pasur mjete që i zotërojmë. Jemi duke bërë përpjekje maksimale me gjetë mjete se me të vërtetë në çdo vit kemi ndarë bursa studimi siç e thatë edhe ju dhe tash në këtë vit është goxha vështirë që një student të mendojë që s'ka me marrë bursë. Sa i përket programit të studimeve e kemi trajtuar këtë temë edhe me vetë studentët ndoshta është një prej arsyeve që unë e kam zhvilluar karrierën edhe në arsim edhe në politika të arsimit. Po besoni, që edhe iu kam thënë haptazi sikurse studentët të ishin fëmijët e mi. Mua më dhimbsen studentët që sot studiojnë juridik, sepse me hy në agjensitë e statistikave të Kosovës, e sheh që kemi prodhuar jurista dikund për 7 milion banorë. Kjo ka qenë arsyeja që të shkoni në profile deficitare, shkoni në mjekësi, shkoni në arkitekturë, inxhinieri civile, janë edhe nja gjashtë apo shtatë profile të programimit inteligjencë artificiale, domethënë aty ku të rinjtë edhe të rejtat vërtetë mbasi t'i mbarojnë studimet nuk trokasën në derë të komunës. Po tani do ta shqyrtojmë bashkarisht edhe në planifikimin buxhetor se tani ka ardhur qarkorja e parë buxhetore. Unë po mendoj që do të fillojmë të stabilizohemi financiarisht prej vitit të ardhshëm edhe do ta kemi një mundësi edhe për politikat arsimore edhe për politikat sociale se edhe grupet sociale domethënë me nevoja të veçanta i kemi shumë keq por nuk ka mjete. Ne mundemi me marrë vendime sa herë të don kuvendi, por problemi është nëse s'ka mjete atëherë është një mashtrim më i madh sesa mos me marrë fare atë vendim. Sa i përket çështjes që e ngriti Fidani, dëshiroj të them disa fjalë. Para së gjithash, e përsëhendes dhe e uroj fillimin e punimeve në stadium. Për mua nuk ka rëndësi nëse jam ftuar apo jo në një ngjarje të tillë. Me shumë sinqeritet

po ju them të gjithëve, e veçanërisht atyre që janë anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, se unë gjithmonë kam treguar respekt për Kryeministrin. E kam respektuar dhe vazhdoj ta respektoj, sepse ai është Kryeministri i vendit tim. Besoj se, nëse ka një kryetar komune që është përpjekur me gjithë përkushtimin e tij të unifikojë faktorin politik dhe të respektojë institucionet shtetërore, ai jam unë. Përfaqësuesit e institucioneve qendrore i kam pritur gjithmonë me respektin më të madh dhe me mikpritje të veçantë. Nuk e përmend këtë rastësisht. I kam mirëpritur sa herë që kanë ardhur dhe, po ashtu, do t'i mirëpres edhe në të ardhmen, sa herë që vizitojnë komunën tonë. Edhe tjetra është që ne e kemi nënshkruar kontratën me Ministrinë e Kulturës. Projekti i stadiumit të qytetit është bashkëfinancim. Janë ndarë 1 milion euro nga komuna e Vushtrrisë. Sa i përket çështjes për stërvitje edhe për lojërë e kemi menduar, kemi biseduar edhe me presidentin e klubit edhe me trajnerin do të bëjmë zgjidhje. Duhet me bë një zgjedhje se me të vërtetë tani jemi në superligë. Kjo është ekipa jonë. Sa i përket pyetjeve të Ymerit këtyre do t'iu përgjigjen drejtorët se kanë qenë në seancën e kaluar unë do të përgjigjem te bashkëfinancimi edhe te prerja e shiritave. Unë e di që ti beson edhe duhesh me më besu që nuk ka projekt që është realizuar e ka qenë në bashkëfinancim e nuk kanë qenë të ftuara institucionet qendrore. Si për rrugën Drenica ashtu edhe për të gjitha rrugët e tjera i kam ftuar. Edhe më ka thënë ish-ministri i infrastrukturës të kërkoj shumë falje kryetar nuk mund të vijmë për shkak të fushatës. Unë po flas sinqerisht edhe unë jam ai që e kam guximin edhe intelektual edhe qytetar që të mbrojë një të drejtë edhe kurrë s'do të ndodhë që unë të anashkaloj. Kur ka qenë fushata larg ka ardhë. Kur është afruar fushata ka thënë jo. Ndoshta edhe po na dëgjon tani drejtpërdrejt le të reagon. Prandaj unë nuk jam anashkalues. Unë s'do të anashkaloj kurrë askënd. Edhe për ditë të çlirimit i ftoj të gjithë deputetët, i kanë vendet e caktuara. Dhe iu bëj thirrje të gjithëve që të jenë të pranishëm me 17 qershor, ditën e çlirimit. Sa i përket pyetjes së Rrahimit për rrethin e Dumnicsë tek Varrezat e Dëshmorëve. Ne i kemi bërë kërkesë disa herë ministrisë. E di që është edhe premtim i kryeministrit. Tani e kanë radhën ta bëjnë atë rreth që është shumë i domosdoshëm. Nëse nuk kanë mundësi ne e kemi një kontratë dhe ajo nuk ka kosto. E marrim e bëjmë vetëm le të na japin pëlqimin. Po them para të gjithë qytetarëve e bëjmë ne le të na lëshojmë pëlqimin. Nuk besoj që do të pengohet komunikacioni. Nuk do të na marrë kohë as një javë ditë. Do ta bëjmë rrethin vetëm na duhet një pëlqim nga ministria. Nëse mundeni me ndiku si anëtarë të kuvendit ndikoni. Thuani një pëlqim na nevojitet edhe shkojmë bashkë. Sa i përket aksit rrugor nga rrethrotullimi te Emona deri në dalje, dëshiroj të sqaroj se kjo rrugë është nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Për këtë kemi bërë kërkesë zyrtare që kjo pjesë të na bartet në kompetencë, duke qenë se nga autostrada deri në Smrekonicë është në administrim të ministrisë. Meqë tashmë është ndërtuar autostrada, kemi propozuar një ridizajnim të saj. Gjendja aktuale është bërë e ndërlikuar, sidomos te rruga “2 Maji”, te rruga “Bekim Berisha” dhe te udhëkryqi te rruga “Shote Galica”. Për këtë kemi menduar që të vendosen rrethrotullime, të cilat do ta lehtësonin ndjeshëm qarkullimin. Tani jemi në pritje të përgjigjes nga ministria për bartjen e kompetencave, ndërsa aktualisht mirëmbajtja dhe asfaltimi i kësaj pjese mbeten përgjegjësi e tyre. Duke qenë këtu, dua të ndaj edhe një informacion tjetër me keqardhje. Dje ka pasur mungesë të ujit të pijshëm për qytetarët, veçanërisht në Ditën e Bajramit. Gjatë gjithë ditës kam marrë shumë telefonata dhe ankesa nga qytetarët, dhe situata ka qenë shqetësuese. Dua të sqaroj se furnizimi me ujë është përgjegjësi e kompanisë rajonale të ujësjellësit, jo e komunës, megjithatë ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me ta. Edhe pse qytetarët shpesh e adresojnë problemin te komuna, ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me kryeshefin e kompanisë dhe situata është normalizuar më vonë. Kërkoj ndjesë qytetarëve për këtë situatë të krijuar, veçanërisht duke qenë se ka ndodhur në një ditë feste. Edhe vetë kam qenë i prekur nga kjo gjendje, pasi jetoj në të njëjtën zonë dhe e kam përjetuar

drejtpërdrejt. Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe besoj se iu jam përgjigjur pyetjeve në mënyrë të qartë dhe të drejtë.

Isa Hajrizi- drejtor i drejtorisë Mbrojtje dhe Shpëtim- Pas përshëndetjes së të pranishmëve deklaroi: U dëgjuan disa kërkesa prej Vlera Tahirit. Më së pari dëshiroj t'i përgjigjem kryetares të grupit parlamentar të PDK-së. Ne si drejtori e kemi të formuar komisionin për vlerësimin e dëmeve. Vlerësimin e dëmeve komisioni e ka kryer me plot ndershmëri edhe me përpikmëri dhe e kanë dorëzuar në komisionin qeveritar. Ata e kanë pranuar vlerësimin e dëmeve. Ata kanë thënë se kanë lëshuar vendim për kompensim, po flas këtu për vitin 2023 por dëmet nuk janë kompensuar ende. Vendimi nuk ka ardhur veç kanë thënë gojarisht. Vendimi nuk ka ardhur as tek kryetari as në drejtori. Ju siç e dini komuna nuk ka buxhet për me i pagu dëmet prej fatkeqësive natyrore.

Benjamin Shala- drejtor i Drejtorisë së Sherbimeve Publike- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: Çështja e kanalizimit dhe varrezave në Druar është kryer para dy seancave atë ditë kemi intervenuar pasdite. Përveç nëse ka pasur ndonjë dëmtim mbrëmë ose dje ditën e Bajramit përndryshe çdo gje është në rregull.

Melihate Basholli-Latifi- kryesuese e kuvendit- Të nderuar anëtarë të Kuvendit, prej Komitetit për Politikë dhe Financa i kemi dhe dy pika shtesë që do t'i hedhim në votim sot për t'i shtuar në rend të ditës. Hap diskutim për rendin e ditës.

Fatmire Cecelia- anëtare e kuvendit- Atëherë unë sot para jush për të tretën herë me radhë po propozoj me fut si pikë të rendit të ditës mbështetjen financiare për fëmijët me nevoja të veçanta. Konkretisht fëmijët që janë të prekur me autizëm dhe me sindromin Down. Fatmirësisht në statistikë janë vetëm 16 fëmijë që vijnë në mësimin e që mundemi me i mbështet. 13 janë me autizëm ndërsa tre janë me sindromin Down. Unë kam propozimin vetëm për këto dy kategori. Ju kisha lut që me mbështet këtë propozim sepse me të vërtetë ka nevojë me i mbështet këto familje. Nuk është një kosto e madhe që brenda muajit me i financu me nga 100 euro. E që i bie brenda vitit për një fëmijë 1200€. Kërkoj nga ju që ta mbështetni këtë propozim.

Ferit Idriizi- kryetar i komunës- Faleminderit, kryesuese. Faleminderit, Fatmire. Është mirë që paraprakisht të dihet buxheti. Nuk është mirë as unë e as ti të bëjmë politikë para qytetarëve, sepse bëhet fjalë për kategorinë më të ndjeshme. Gjithashtu, nxjerrja e një vendimi pa pasur mjete financiare për ta realizuar është edhe më keq. Për shembull, ende u kemi mbetur borxh atyre qytetarëve të cilëve u janë djegur stallat e shtëpitë para dy vitesh. Kemi marrë të dhënat, kemi shkuar për t'i vizituar, por nuk kemi pasur mjete financiare dhe nuk kemi mundur t'i mbështesim. Po ju tregoj se nuk është vetëm ai numër; ka edhe të tjerë me nevoja të veçanta. I kam nxjerrë të gjitha të dhënat për personat me nevoja të veçanta. Në sistem kemi gjithsej 195 fëmijë. Janë 195 fëmijë me probleme shëndetësore dhe këto kategori nuk mund të ndahen. Siç e përmenda edhe më herët, po të mos na ishin marrë ato mjete, rreth 13.600.000 euro nga përmbaruesi, sot do të kishim mjete dhe subvencione për t'i mbështetur këto kategori. Kur mbështeten kategori të tilla, duhet të mbështeten të gjitha. Prandaj, para çdo projekti duhet të dihet vlera financiare dhe kostoja. Duhet të përcaktohet sa mjete nevojiten dhe të pyetet ekzekutivi nëse ka mjete në dispozicion. Nëse nuk ka, atëherë projekti planifikohet për vitet e ardhshme. Tashmë ka ardhur qarkorja buxhetore dhe ne nuk e votojmë buxhetin vjetor pa e përfshirë paraprakisht një planifikim të tillë. Kjo është një politikë parimore dhe transparente. Nuk mund të propozojmë diçka vetëm që ta votojë kuvendi. Ju mund të votoni dhe të propozoni, por unë nuk mund ta ekzekutoj nëse nuk ka mjete financiare. Gjithçka lidhet me mundësitë financiare. Për këto kategori, transporti është falas. Shumë prej tyre janë subvencionuar, sidomos familjet që kanë bërë kërkesa dhe që janë në gjendje të rëndë sociale. Ka familje që kanë fëmijë me Sindromën Down dhe njëkohësisht përballen me vështirësi

ekonomike. Ka edhe familje që e kanë gjendjen ekonomike më të mirë dhe nuk kanë pasur nevojë për mbështetje financiare, ndonëse përballen me të njëjtën sëmundje. Ne kemi bërë përpjekje t'i mbështesim të gjithë sipas mundësive. Aktualisht, 24 fëmijë në shkolla janë të përfshirë në sistemin e asistencës me asistentë. Gjithashtu, pritet të rekrutohen edhe 12 mësuese asistente, të cilat tashmë e kanë përfunduar trajnimin e veçantë njëvjeçar për punë me këta fëmijë. Prandaj, le të punojmë bashkërisht, sepse edhe ju përfitoni para qytetarëve kur politikat bëhen si duhet. Tani jemi në fillim të procesit të planifikimit buxhetor dhe ka ardhur qarkorja e parë buxhetore. Do t'ju paraqesim të gjitha të dhënat: sa borxhe kemi, sa kontrata kemi dhe cila është gjendja financiare. Analizoni, kalkuloni dhe ejani me propozime. Ju përfaqësoni qytetarët e Vushtrrisë dhe i njihni më së miri lokalitetet ku jetoni. Kjo do të ishte politika e duhur. Edhe meritat do t'i merrni ju, sepse ju votoni buxhetin. Mirëpo, të kërkohet vazhdimisht mbështetje financiare për grupe të ndryshme në një kohë kur nuk ka mjete financiare, është e pamundur të realizohet. Nuk ka mjete. Edhe projekti i Banesave të Bardha është zvarritur për shkak se nuk kemi mundur t'i përcjellim pagesat. Tani, nga të hyrat dhe investimet kapitale, pagesat do të vazhdojnë dhe projekti duhet të përfundojë. Më së shumti do të kisha dashur që Banesat e Bardha të përfundonin para zgjedhjeve, sepse do të përfitoja politikisht më shumë, pasi i kam premtuar. Por nuk kam mundur. Ndërkaq, për rrethrotullimin kemi kontratë me operatorët. E kam fjalën se aktualisht nuk ka mjete në thesar për të ndarë për këtë kategori. Prandaj, kryesuese dhe të nderuar anëtarë, e di ndjeshmërinë që secili prej jush ka për këtë kategori. Tani kemi qarkoren buxhetore dhe do të planifikojmë politika arsimore, sociale dhe politika të tjera. Kur të votojmë buxhetin në shtator, atëherë do t'i kemi gjërat më të qarta.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- Edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi diskutuar mjaftueshëm këtë temë. Besoj se askush nuk është kundër kësaj çështjeje, por sfida qëndron te gjetja e mundësisë reale për realizimin e saj.

Fatmire Cecelia- anëtare e kuvendit- Kryetar më së pakti ndoshta këtu në kuvend unë di me bë politikë dhe bëj politikë sidomos me këtë çështje nuk bëj politikë asnjëherë sepse ne që kemi anëtarë të familjes në këto kategori më së shumti na dhemb e kështu që këtu te ne fatkeqësisht duhet me të provu Zoti për me bashkëndje. Edhe nuk është që po bëj politikë absolut. Ju kam treguar edhe ju kam kërkuar më herët me më dhënë statistika për buxhet. Nuk është një kosto e madhe 19.200 €. Ju kryetar mundeni me e marrë vendimin mbasandej me zbatu retroaktiv sikurse shumë vendime të tjera, apo ju kryetar keni edhe vendim në fuqi që është për fëmijët të posalindur dhe nuk i keni financuar me vite. Është e treta seancë që propozoj radhazi gjithashtu iu kam dërgu email drejtorisë së shëndetësisë dhe nuk kam marrë përgjigje.

Refik Maloku- anëtar i kuvendit- Pasi i përshëndeti të gjithë deklaroi: Mua më vjen mirë që kryetarit kur i vijnë ia nisë me u arsyetu, kur nuk i vijnë e përdorë atë metodën tjetër. Po të pyes kryetar a e ke rishikuar buxhetin ti kur ke vendosur me i pagu nga 22.000€ disa këshilltarë në disa pozita që s'kanë ekzistuar. A ke menduar a do të ketë mjete financiare për fëmijët të cilët i përmendi Fatmirja apo ke mendu veç për me i përmbush interesat e tua personale dhe të individëve që ti ke afërsi familjare me ta? Mos u viktimizo. Kryetari po thotë për arsye se nuk kemi mjete, ne nuk po mundemi me e zbatu këtë. Duhet paraparë me kohë mjetet. A i ka paraparë kryetari me kohë mjetet kur 22.000€ ju kanë ndarë të afërmeve të vet për pozita të cilat nuk ekzistojnë e tash thotë nuk ka mjete financiare për njerëz të sëmurë.

Ferit Idrizi- kryetar i komunës- Sesi e kam bërë menaxhimin e kanë vlerësuar qytetarët e Vushtrrisë. Ma kanë dhënë votën, kanë thënë mirë ke menaxhuar, vazhdo. Veç po dua një sqarim rreth asaj që unë jam shumë i bindur. Nuk po dua të mendoj që ka anëtarë të kuvendit që nuk i din kategoritë buxhetore edhe prej cilit kod buxhetor mundesh me i mbështet konsulentët, prej cilit

kod buxhetor mundesh me shtru një rrugë, prej cilit kod buxhetor mundesh me i mbështet këto kategori. Kodi buxhetor, subvencione dhe transfere. Edhe nëse ke mjete financiare më shumë se të mjaftueshme në investime kapitale edhe në mallra e shërbime nuk mundesh me i pagu këto se është e caktuar. Unë e di që ju e dini. Prandaj këtë po e them këtë për qytetarët, sepse krijohet përshtypja se diku ka mjete financiare, ndërsa diku tjetër jo. Subvencionet dhe transferet kanë një kufi të caktuar. Edhe kur planifikohet buxheti, ekziston një tavan buxhetor që përcakton sa mund të ndahet nga buxheti i përgjithshëm për subvencione dhe transfere. Jam plotësisht dakord me atë që tha Fatmirja. Ne nuk i kemi paguar lehonat pikërisht sepse ato mbulohen nga kodi i subvencioneve dhe nuk kemi pasur mjete financiare të mjaftueshme. Nëse nuk ke pasur mjete për t'i paguar lehonat dhe as rastet e tjera që trajtohen përmes subvencioneve, siç janë dëmtimet nga djegia e shtëpive, stallave apo raste të ngjashme, atëherë si mund të merret një vendim i ri për të rritur edhe më tej obligimet financiare? Kjo është ajo që po them: të mos nxitohemi, por së pari ta stabilizojmë buxhetin. Do të ishte mirë, si intelektualë dhe si përfaqësues të qytetarëve, të kishte reagime edhe për çështje të tjera. Për shembull, të thuhej: “Paguani mjetet për mësimdhënësit, sepse komnatat janë rënduar financiarisht dhe janë vënë në vështirësi.” Nuk e keni thënë këtë, por nuk po ju kritikoj për këtë. Unë personalisht do ta kisha thënë, sepse besoj se kam guximin intelektual për t'ia thënë çdo qeverie. Mirë, gjithçka është në rregull. Por tani, në vend që përgjegjësia t'u atribuohet atyre që na kanë lënë barrën prej 13 milionë e 600 mijë eurosh, kritikën drejtohen ndaj kryetarit të komunës, duke u thënë se nuk po realizon këtë apo atë projekt. Unë po e them në mënyrën më transparente të mundshme: nga kodi që e përmendi profesori Refik, këto pagesa nuk mund të realizohen. Kjo është e qartë. Dua ta sqaroj këtë para jush, sepse prej muajsh janë paraqitur shumë propozime nga ana juaj dhe të gjitha kanë qenë të mirëseardhura. Nuk ka asgjë të keqe në këtë. Faleminderit.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- Pra kjo çështje po propozoj që secili anëtar i Kuvendit le të angazhohet edhe më shumë ashtu siç jemi angazhuar disa prej anëtarëve të kuvendit që këtë çështje ta trajtojmë me buxhetin e vitit të ardhshëm për arsye se ashtu siç e shpjegoi kryetari dhe drejtori i buxhetit në komitet na e ka shpjeguar që nuk kemi vijë buxhetore ku përmes së cilës mund t'i paguajmë këto kategori. Kalojmë te pikat që i kemi diskutuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe që i kemi rekomanduar për kuvend. Pika e parë është propozim-vendim për dhënien e titullit Nderi i Qytetit me të cilin do të nderohet zotëri Nesim Ispahiu. Kush është për ta shtuar në rend të ditës këtë pikë? E hedh në votim. Jemi të pranishëm 22 anëtarë sipas sekretarisë. **Kush është për, për ta shtuar këtë pikë të rendit të ditës? 21 janë për. Konstatohet që shtohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.** Pika e radhës është propozim-vendim për dhënien e çmimit emblema e Vushtrrisë, e cila me të cilën do të nderohet zotëri Janus Halili. Kush është për? **21 janë për. Konstatohet që dhe kjo pikë shtohet në rend të ditës për shqyrtim.** Pika që e propozoi Fatmirja nëse kishim pasur dakordancë, e kishim lënë për buxhetin ashtu siç duhet me qenë me rregulla. Në votim mundemi me hedhë po ne nuk jemi për me votuar diçka që nuk realizohet.

Diellza Pllana- anëtare e kuvendit- Zonja Fatmire edhe seancave të kaluara ka propozuar ta fus në rend të ditës këtë pikë. Edhe seancave të kaluara kemi propozuar që të na sjellët një dokument. Në qoftë se thoni që është e mundshme. Dëshirojmë të kemi një dokument sesi bëhet sipas jush. T'i kemi statistikën sepse unë nuk dua të votoj për diçka që nuk mundemi me ia dhënë më pastaj mbështetjen financiare. Kështu që kërkoj prej teje të paktën kur jepni propozime duhet me pas një dokument, sepse s'kemi pse votojmë as për as kundër as abstenim kur nuk dimë për çka. Kështu që nëse mendon që realizohet, na trego sesi realizohet, më jep edhe statistikën dhe unë pastaj zgjedhë sesi me votu.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- U diskutua atë çka e tha Diellza, e tha edhe

kryetari, e ka thënë edhe drejtori, po e them edhe unë vazhdimisht meqënëse ju po insistoni, unë po e hedh në votim kush është për ta aprovuar, por realizimi nuk është i sigurtë.

Blerina Shala- anëtare e kuvendit- Përsëritet për të gjithë. Edhe në Komitet për Politikë e Financa kemi diskutuar të njëjtën çështje është e tepërt gjithë këtë diskutim për këtë kategori kaq të ndjeshme. Fatmire nuk mundesh me i nda fëmijët me autizëm edhe me ngecje në zhvillim sepse problemet i kanë të njëjta. Si të propozohet kur nuk kemi buxhet. Ata do të presin për t'i marrë mjetet financiare e ato mjete nuk kanë me i marrë asnjëherë. Kryetari le të na premton që do të ndahet në buxhet por jo vetëm për këtë pjesë por për të gjithë.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- Faleminderit. Me të vërtetë është një kategori e ndjeshme dhe pothuajse secili ka dikë në familje ndoshta jo fort të ngushtë që i ka me këto probleme. E rëndësishme është me realizu këtë. Meqënëse kryetari, drejtori i buxhetit po na tregojnë që nuk ka mundësi buxhetore, unë po propozoj që për shkak se këta nuk kanë mjete, ekzekutivi s'ka mjete financiare, nuk do ta procedojmë as për këtë seancë, por do të punojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtohet në një nga seancat pas miratimit të buxhetit.

Ferit Idrizi- kryetar i komunës- Jo vetëm këta 13 që i përmendi zonja Fatmire, por përfitues do të jenë 195 kur planifikohet buxheti. Pra që me qenë përfitues të gjitha kategoritë.

Melihate Basholli- Latifi- kryesuese e kuvendit- Unë po kërkoj edhe prej kryetarit edhe prej drejtorive përkatëse, prej anëtarëve të kuvendit ta japin maksimumin që me pas numrin e saktë edhe materialin me pas të kompletuar me numër të fëmijëve, me diagnoza, me vijë buxhetore në mënyrë që ne ta fusim në rend të ditës. E hedh në votim rendin e ditës me dy pika shtesë që i votuam individualisht.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” aprovoj këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 prill 2026;
2. Propozim – vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026;
3. Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore për vitin 2027 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike;
4. Propozim – vendim për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
5. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën mars – gusht 2025 dhe periudhën janar – shkurt 2026;
6. Propozim-vendimi për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit”;
7. Propozim-vendimi për dhënien e çmimit “Emblema e Vushtrrisë”;
8. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrisë e mbajtur në datën 30 prill 2026.

Pas shqyrtimit kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrisë e mbajtur në datën 30 prill 2026, me vërejtejn që të korrigjohet ermi i z. Lorik Maxhuni, ku në vend të tij duhet të jetë z. Mentor Hasani.

2. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026;

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se bazuar në Ligjin për Ndarje Buxhetore dhe Ligjin e Vetqeverisje Lokale është obligative që bëhet, propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026. Ju e dini që muajin dhjetor për shkak të tejkalimit të hyrave që kemi pasur këtë seancë të kuvendit patëm marrë vendim dhe patëm bërë shpërndarjen. Mirëpo të hyrat e dhjetorit barten në vitin 2026. Në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi diskutuar shuma e bartjes së mjeteve është 575.404.93 €. Nga kjo shumë në kategorinë e mallrave dhe shërbime bartet shuma 231.979.45. Në kategorinë e komunalive bartet shuma 30.000 € dhe kategorinë e investimeve kapitale bartet shuma 313.400 25.48. Mirëpo me propozim të Sekretarisë së Kuvendit kemi bërë një ndryshim të vogël. Arsyeja pse shumë herë është diskutuar në këtë seancë të kuvendit lidhur me pajisjet e zërimit dhe votimit elektronik për sallën e Kuvendit. Mirëpo meqenëse është koha dhe momentet që ta inkorporojmë si projekt në tabelën 4.2 si projekt të ri, kostoja e projektit është 60,000.00 €, 40.000 € merren nga kategoria e mallrave dhe shërbime në programin 18184 në infrastrukturë publike dhe 20.000 € merren nga kodi i projektit 54798 ndërtimi i rrugëve lokale Dumnice Maxhunaj Stanov Lumadh Vilanc dhe Ropic e Pestovë do të thotë kjo shumë mbartet në këtë projekt të ri që është pajisje për zërim dhe votim elektronik për sallën e Kuvendit të komunës së Vushtrrsë vetëm me këtë ndryshim të tjerat janë projekte ekzistuese të gjitha që janë kontraktuale që duhet me u përfunduar dhe realizuar në vijimsi.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- tha se çështja që dëshiron me u ndërlidh tek propozimi i drejtorit. Drejtori përmendi që vetëm është votimi elektronik edhe zërimi. Këtu mungon, po besoj që tash secili e dimë që salla e kuvendit e reja zhvendos në Qendrën Rinore, është jep hapësira atje për rinovimin e objektit të ri për kuvendin komunal. Mendoj që në këtë vijë buxhetore duhet të futet edhe inventare, por edhe kamera më të pastra për shkak se me këto kamera të cilat janë edhe po transmetohen tek publiku po janë shumë të vjetra edhe nuk kemi mundësi që secili prej anëtarit të kuvendit kur flet edhe nga vendi të merret pamje e saktë për kush për çka po flet. Kështu që mendoj që duhet ta vendosim edhe pjesën e kamerës por edhe të inventarit të ri për arsye se ky inventar nuk i plotëson të gjitha kriteret për të vazhduar përpara me punimet e kuvendit.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e kuvendit- tha se sa i përket inventarit, në këtë kod mirëpo është çështja që kostoja e saj është shuma 60.000 euro do të thotë nuk e dimë që ai a i përballon kjo shumë komplet propozimet e juaj. Dhe shtoj se inventari mundem me u realizuar edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbime. Pajisje, zërim dhe votim në këtë kuadër hynë edhe kamera. Unë si anëtare e kuvendit nuk nuk kisha pranuar me e prek këtë shumë me inventar. Inventari propozoi me qenë një vijë tjetër buxhetore.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- unë sot e kuptova lokacionin e sallës së kuvendit. Nuk po mendoj që është ide e mirë me i nxënë hapësirat e rinisë Qendra Rinore është e dedikuar për rininë Vushtrriase. Nuk mendoj që është mirë me marrë hapësirën e rinisë se është e vetmja hapësirë që ata mund me shfrytëzu. Keni lokacione të ndryshme e keni këtu që Drejtoria e Inspektimeve nuk është në objekt po mendoj që është më mirë me adaptu këtu diku brenda komunës ose një objekt tjetër me paraparë e jo në Qendrën Rinore. Edhe ju kisha lutur e kam si kërkesë edhe nëse veç se ju përdorni arogancën e numrave e keni pushtetin e krejt sallën e kuqe në Qendrën Rinore mos me prish nëse mendoni definitivisht me shku atje me ba sallën jashtë që është në anën e majtë e jo me prish Sallë e Kuqe, sepse është një investim shumë i mirë edhe është një investim afatgjatë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se sa i përket bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026. Unë desha veç disa sqarime këtu tek planifikimi urban, inspeksioni, Vushtrri nga projektet po thuhet që është ndërtimi i rrugëve lokale dhe përmendet fshati Stanoc. Tash a është fjala për Stanocin e Epër apo Stanocin e Poshtëm është më mirë me definuar sepse janë dy

Stanoca edhe përafarësisht me ditur shumën për secilin fshat po ashtu po përmenden edhe Dumnicat prandaj është mirë me kanë të specifikuar jo me lënë në mënyrë të përgjithshme e pastaj me e keqpërdorë këtë emër sepse zyrtarisht pra e dimë që në komunën e vërtë janë dy emërtime, Stanoci i Epërm dhe Stanoci i Poshtëm dhe kjo duhet definuar. Çështja tjetër është tek blerja e veturave për administratën komunale në Vushtrri ku janë të planifikuar me 72.639 €. A është fjala këtu për pagesën e këtyre dy veturave që janë blerë më herët veç janë ardhë apo do të blehen edhe dy vetura të reja për administratën? Sepse sigurisht që ka nevojë për këto vetura. Po e dimë që ka edhe disa vetura për të cilat ju paguani qira vazhdimisht kur na vijnë listat për shpenzime pra keni qira të paguar. Pyetja është a janë këto mjete për veturat që kanë ardhë në komunë. Sespe drejtori në njërin nga seancat ka thënë që kanë qenë të planifikuar me buxhetin e vitit të kaluar dhe janë realizuar në mbledhjen e kaluar më kujtohet drejtor që ke thënë apo janë vetura të reja dhe për fund desha veç me i kujtu kryesueses pasi që po thotë se kam përvojë shumë të gjatë kryesuese kur një asamblesë propozon diçka për rend të ditës je e obliguar me qitë propozimin në votim a votohet për/kundë apo abstenim mbeetet në vullnetin e kuvendit . Asambleistja jonë bëri një propozim për të cilën në mënyrë dinake kryesuesaj iku dhe nuk e qiti propozim e saj në votim. Po ta kujtoj se po thua se kam përvojë goxha të gjatë edhe e di që ke përvojë prandaj e ke pas obligim ligjor me e hedhë në votim propozimin e asambleistes së Lëvizjes Vetëvendosje.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se sa i përket pyetjeve të cilat i parashtroi deputeti lidhur me blerjen e veturave është shumë e vërtetë që është projekt që kemi votuar edhe në këtë seancë të kuvendit. Ne i kemi udhëhequr të gjitha procedurat e rregullta ligjore dhe kemi marrë dy automjete qysh kam thënë edhe më herët për shkak se me ju ik automjeteve të cilat i kemi me lezing dhe me mbet si aset i komunës. Mirëpo përmbaruesi na i ka marrë kaq mjete fiks dhe kemi qenë të obliguar me përmbyllë kontratën dhe me plotësuar këtë pjesë të mirë. Ndërsa sa i përket projektit ndërtim i rrugëve lokale, ky është një projekt qysh nga vitet e kaluara që bartet vit mbas viti për shkak se fondin për bashkëfinancim me donatorë të cilin e kemi qysh e kemi rastin tek asfaltimi i rrugëve në Duminë me Ministrinë e Infrastrukturës nga ky kod i projektit zakonisht plotësojmë pjesën e kontratës të cilën e kemi me bashkëfinancim me donatorë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, 5 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga fondi (21) për vitin 2025 në vitin 2026 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime	231,979.45 €
1.2 Komunal.....	30,000.00 €
1.3 Investime kapitale.....	313,425.48 €
Totali i mjeteve të bartura.....	575,404.93 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë e tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë, tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3. Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore për vitin 2027 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike;

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit, duke shtuar se me datën 15/5/2026 në bazë numrit të protokollit 06/40 Ministria e Financave ka dërguar qarkoren buxhetore 2027/01. Kjo qarkore buxhetore përmban kufijtë fillestarë buxhetor si për nivelin qendror ashtu dhe kufijtë buxhetor për nivelin komunal për periudhën 2027-2029. Buxheti sipas qarkores për vitin 2027 është 31.683.485 €. Granti i përgjithshëm është 13.366.900.992 €. Granti i arsimit është 10.703.206 €. Granti i shëndetësisë është 3.231.203 €. Shërbimet rezidenciale i kanë të njëjta 200.000 €. Shtëpitë e komuniteteve 230.000 €. Gjithsej të hyrat nga grantet qeveritare janë 27.731.331 €. Kategoria e të hyrave vetanake janë 3.952.154 € që do të thotë granti plus hyrat vetanake arrijnë shumën 31.683.485 €. Tek granti i përgjithshëm e kemi një rritje prej 1.56.296 që i bie përqindje 8.65. Tek arsimi e kemi një ulje prej 58.404 €. Tek granti i shëndetësisë e kemi një rritje prej 5.23 apo në vlerë monetare i bie 9.151 si dhe te shtëpitë e komuniteteve. Vitin 2026 i kemi pas 200.000, në vitin 2027 i kemi 230.000, është një rritje prej 30.000 € që do të thotë në total është një rritje prej 1.621.550 € apo 5.12%. Në bazë të qarkores buxhetore dhe në bazë kalendarit kohor lidhur me planin buxhetor jemi të obliguar bashkëpunim me kryetarin, kryesuesen t'i formojmë grupet për hartimin dhe marrjen e kërkesave për planin e buxhetit për vitin 2027-2029.

4. Propozim – vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- 1.1. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës – Kryesues;
- 1.2. **Reshat Kovaqi**, Komandant i Stacionit Policor – anëtar;
- 1.3. **Naile Bekteshi**, Drejtoreshë për Arsim – anëtare;
- 1.4. **Bajram Beqiri**, Përfaqësues i sektorit të emergjencave – anëtar;
- 1.5. **Aldi Blyti**, përfaqësues i FSK-së – anëtar;
- 1.6. **Hadije Zuqaku**, Kryetare e Këshillit të Prindërve të Arsimit të komunës anëtare;
- 1.7. **Remzije Zekolli**, Zyrtare për Barazi gjinore dhe të Drejta të njeriut – anëtare;
- 1.8. **Stefan Markovic**, Kryesues i Komitetit për Komunitete;
- 1.9. **Ejup Haziri**, Përfaqësues i Bashkësisë Islame në Vushtrri – anëtar;
- 1.10. **Lubomir Jasiq** Përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe – anëtar;
- 1.11. **Banush Elezi**, Përfaqësues i Kishës Protestante Ungjillore – anëtar;
- 1.12. **Bozidar Artonovic**, Përfaqësues i komunitetit serb - anëtar;

- 1.13. **Semra Gjushinca Llapashtica**, Përfaqësuese i komunitetit turk – anëtar;
- 1.14. **Adem Hoti**, Përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;
- 1.15. **Selatin Emini**, Përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;
- 1.16. **Habib Mustafa**, Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Beçuk dhe Mihaliq – anëtar;
- 1.17. **Gjylsime Feka**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi, për fshatrat: Banjskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërllabuq, Karaçë, Begaj, si dhe “Kalaja” Vushtrri – anëtar;
- 1.18. **Ekrem Merovci**, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi – anëtar;
- 1.19. **Branisllav Vuksanoviq** Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim anëtar
- 1.20. **Vildane Mulaku**, Kryetare e Shoqatës “Martirët e Lirisë” (OJQ) – anëtare;
- 1.21. **Hakif Kalludra**, Përfaqësues i komunitetit të biznesit – anëtar;
- 1.22. **Isak Hyseni**, Përfaqësues i komunitetit të peronave me aftësi të kufizuara anëtar;

2. Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MPB-së për themelimin e KKS-së.

3. Mandati i KKS-së është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

4. Në rast se anëtari/ ja i/e KKS-së nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi ose për çfarëdo sjellje ose veprim e komprometon funksionin efektiv të KKS-së, me propozimin e Kryesuesit të KKS-së, Kuvendi i Komunës emëron anëtarin tjetër të këtij këshilli.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën mars-gusht 2025 dhe periudhën janar – shkurt 2026.

Vlerë Tahiri, anëtare e kuvendit- atëherë unë po i qëndroj edhe njëherë kërkesës time që me dërguar dhe me i bë presion ministrisë përkatëse edhe për raportet e viteve të kalumara, pasi që komuna është duke e kryer punën, mirëpo po has në vesh të shurdhër prej Ministrisë përkatëse. Kështu që unë kërkoj sot fjalën edhe drejtorit edhe të kryetarit që kanë me bë presion edhe qytetarët nuk kanë me u dëmtuar më prej këtyre premtimeve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se e dimë që gjatë këtyre viteve kemi pasur dëme edhe fatkeqësi natyrore edhe si pasojë e motit të ligë, edhe motit të ftohtë, edhe shiut, edhe erave, edhe motit të nxehtë. Dhe në vitin 2024 një mikut tim i ka ndodhur po ashtu një dëm i madh prej fatkeqësive natyrore. Këtu në kuvend e pata propozuar për një ndihmë, mirëpo në të njëjtën seancë të kuvendit, një asamblestë në atë kohë i PDK-së e patë prpozuar për një ndihmë për shërim dhe unë pata tërheq kërkesën me marrëveshje me kryetarin që me formu një komision edhe me shku me bë vlerësimin e dëmeve në atë familje. Ka qenë një dëm i madh jashtëzakonisht kështu që asnjëherë nuk na ka bërë, nuk na ka pruar raport rreth atij dëme që është bërë. Kisha kërkuar që në kuadër të këtyre dëmeve, jo pse ai është familjari imi, por të gjitha dëmet të cilat janë bërë nga periudha që e përmendi kolegja asambleistja nga Partia Demokratike, pra nga viti 2023, 2024, 2025, 2026 le të përmbledhen të gjitha dhe ne e dimë tash po e shohim situatën si është me financa, po së paku që të jenë të përfshime në raport t'i aprovojmë si kërkesa edhe t'i dërgojmë

në ministri të linjes përkatëse e të cilët besoj që ka qenë edhe premtim i kryeministrit që do të kompensohen. Prandaj kërkoj edhe njëherë pra nëse është bërë vlerësimi të sjellet ai raport në njërën nga seancat e kuvendit. Por jo veç të atij, por edhe të gjithë domethënë bizneset, fermerët, familjet, ekonomitë familjare që janë dëmtuar të përpilohet raporti t'ju dërgohet herë ministrive të linjës dhe besoj që ato pastaj do të kompensohen.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se pajtohet plotësisht me anëtarin e kuvendit z.Ymer Haradinaj. Kur ishte duke diskutuar për rendin e ditës këtë çështje unë i përmenda që ka të them singertë nuk dasha me përmend kështu me emër po e lash me u kuptu se ka që dikund janë djeg shtallat edhe janë bërë dëme në komunën e Vushtrrisë jo vetëm rasti tash meqë e përmendi po e përmendi më lirshëm i mikut tuaj që është nga Novolani po i kemi edhe disa raste të djegies së shtëpive bile tash në fund para dy tre jave në fshatin Ceceli dikujt ju ka djegur shtëpia në tërësi. Prandaj ai deklaroi që bashkë me Drejtorinë për Emergjencë do ta ripërsërisim kërkesën edhe do t'i përmbledhim të gjitha këto dëme që janë shkaktuar. Dhe mos të marrim si presion se na jeni institucione dhe funksionojmë në mënyrë institucionale. Do përsërisim ripërsërisim kërkesën edhe do ta do ta dërgojmë. Meqë jam këtu, nëse më lejoni dhe nuk me keqkuptoni unë kisha kërkuar prej juve kryesuese, e ke zyrtarin këtu që po të rrin në krah, është jurist, është jurist me përvojë dhe kërkoj prej juve singërisht kërkoj që ta ndihmoni kryesuesen kur është në pyetje tek votimi në aspektin juridik që mos të bëhen shkelje se nuk është vendi yt veç me ndejt aty e me të pa anëtarët e kuvendit, sepse këtu shumë qartë është përcaktuar me ligj për pikat shtesë të rendit të ditës. E thotë neni 47 pika 2 e Ligjit për Vetqeverisje Lokale <çdo deputet anëtar i kuvendit ka të drejtë të propozojë, domethënë të kërkojë shtimin e një pike të rendit të ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës, është urgjente dhe me rëndësi publike. Prandaj si do që të jetë ajo nuk ishte çështje urgjente sepse po të ishte do të ishte zgjidhur ngaherë. Çështje urgjente është na vjen një rast që duhet urgjentisht me çu me me intervenu për shembull në spital ose diçka tjetër. Megjithatë mbështeti mos t'i kthehem edhe njëherë. Nuk e kam te ju tash. Tash e kam te stafi i komunës, tek juristi që në situata të tilla mundet me i thënë kryesueses, shiko, ka të drejtë me propozu secili, por janë mundësitë buxhetore, ka kaluar në komitet, nuk i ka marrë votat në komitet edhe mos na futni në rend të ditës. Pra, kërkoj që herve të tjera të jeni më të konsoliduar. Kryesuesja ka përvojë, por nuk është juriste. E ka juristin, Sekretarinë e Kuvendit. Edhe në mënyrë që mos të kemi keqkuptime mes anëtarëve me mendu që i kemi votat edhe s'ju pyesim fare. Ajo teori nuk vlen. Keni me qenë të respektuar, keni me qenë të mbështetur, por ta dimë çka po shtim në rend dite. Lidhur me raportin e dëmeve kërkoj që të përgatitet me shtojcat me të gjitha kërkesat. Krejt kjo në kuadër të komisioni në kuadër të Drejtorisë së Emergjencave, drejtor prej teje kërkoj që të ripërsëritet ajo edhe pse jo edhe anëtarëve të kuvendit dërgoju në email është transparencë pse mos me ju dërgu me ditë për secilin ku jemi dhe çka mundem me bë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në Komunën e Vushtrrisë, për muajt: mars- korrik 2025 dhe janar-shkurt 2026.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (erërat e

forta, breshëri dhe zjarret), që kanë mbretëruar në periudhën e sipërcekur, në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare në vlerë totale prej 129,368.20 € (njëqind e njëzet nëntëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë ero e njëzetë centë), si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Propozim-vendimi për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit”;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se askush nuk është kundër këtij zotrie që ta marrë këtë titull, por kërkoj që herve tjera mos të vendoset kuvendi para situatave dhe fakteve të kryera. Ai kërkoj të ketë koordinim dhe bashkëpunim mes kuvendit dhe kryetarit të komunës që këto çmime të jenë vërtet meritore dhe të aprovohen me unanimitet të plotë.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- tha se të dy çmimet që na kanë ardhur “Nderi i Qytetit” dhe “Emblema e Vushtrrisë” janë vërtetë dy persona shumë meritore. Për dallim nga ajo që çdo propozim që vjen prej neve nuk e mbështetnin ne i mbështesim edhe fuqishëm. Z. Nesim Ispahiu është një njeri që e lidh historinë të kaluarën me të tashmen. Jeni arritur me fotografi i tij, dhe Vushtrria si qytet identifikohet me fotografi të z. Nesim Ispahiu. Ndërsa sa i përket z. Januz Halili, edhe ky është një person që me të vërtetë e meriton, është një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njëri ndër personat që është më i lënduar në luftën, domethënë është invalid i luftës që ende ka plagë dhe është një person që vërtetë e meriton. Lufta e UÇK-së, e dimë që është e shenjtë. Grupi jonë i mbështet këto dy propozime.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se i falenderon të gjithë parafolësit edhe për sugjerime edhe për qasjen. Me të vërtetë këto propozime janë proceduar përmes komisionit. Është një komision si e kërkon ligji, por jemi munduar që këto figura me të vërtetë me qenë të pakontestueshme. Nuk është hera e parë që bashkarisht votojmë edhe jepim çmime çdo herë kemi qenë unik në këtë drejtim, edhe në mandatin e kaluar kur kemi qeverisur. Pa gabime nuk jemi por jemi munduar që me të vërtetë këto dy figura, z.Nesim Ispahiu, që është nder edhe për neve edhe për mua si kryetar edhe për juve që në një moshë çfarë e ka ai dhe me një qasje pozitive, me një vitalitet çdo herë mendon për qytetin e Vushtrrisë. Unë ju falenderoj për qasjen, po edhe për z.Januz Halili si një invalid i luftës. Tash nuk po dua me shpërfaq atë, me tregu që kam qenë një prej protagonistëve kur është plagosur. Edhe Januzi është plagosur, duke çminuar minat ku gjatë ditës i vendosnin

forcat serbe edhe ato i vëzhgonte me dylbi, dhe më tej shkonte dhe i çmontonte, sa që ka pas mina me thes që ai i ka hapur rrugët edhe për popullatën civile për me u largu prej Qyqavice por edhe për ushtarët e UÇK-së. Po fati i keq e deshti se në një moment në një minë befasie bjen edhe i shkon këmba Jonuzit. Kështu që unë veç mundem me ju falenderuar për këtë unifikim të votës. Jeni të merituar kur jemi në këto raste duhet të qendrojmë unik.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se zakonisht kur ka qenë çështja për dhënien e këtyre çmimeve kemi qenë unik. Mirëpo përveç këtyre dy çmimeve që janë sot, kuvendi në bazë të rregullores ka të drejtë me i dhënë edhe 10 mirënjohje. Pra, ne e dimë që po e shohim në vazhdimësi kryetari i komunës që shpërndan mirënjohje. Po kisha pasur dëshirë këtu nëse është e mundur me propozu një person për mirënjohje. Është fjala për z. Ukshin Malokun pas vdekjes. Ai ka vdekur para një kohe, por që e ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm nga mërgata për Stanocin e Epërm, konkretisht për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës fillore “Migjeni”, Stanoc i Epërm, gjatë periudhës para lufte, gjatë luftës, por dhe pas luftës. Pra, vazhdimisht ai person ka dërguar ndihma, veçmbathje, por edhe mjete financiare për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës. Ka vdekur para dy tre muajsh sigurisht. Më kanë treguar që ka qenë kryetar i komunës. Ai krejt anëtarët e familjes i ka jashtë këtu i ka dy vëllezër, Ismet Malokun edhe Adem Maloku. Pra nuk është çështje politike. Besoni që ata janë njerëz që kanë kontribuar vazhdimisht, por në shenjë mirënjohje dhe respekti. Pra pas vdekjes, postmortum kisha propozuar që t'i jap një mirënjohje z.Ukshin Malokut nga Stanoci i Epërm.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- tha se e mbështetë plotësisht propozimin e z.Haradinaj. dhe shtoj se për herë të parë ka filluar në Stanoc të punoj, dhe e di kontributin e tij. Është e vërtetë ashtu, por ajo që kisha dashur me theksu e kam përmendur edhe njëherë arsyeja pse s'po i sjellim në kuvend. Tash jemi tute plotësuar dhe ndryshuar rregulloren e punës të kuvendit. Edhe unë nuk kam dashur që mirënjohjet të shkojnë përmes kuvendit, sepse po do me thënë thjesht kuvendi është për punë më të mëdha. Tjetër ashtu siç është e përcaktuar me rregullore është e normuar që mirënjohjet me u ndarë në votim të fshehtë. Ju e dini që në të kalumen goxha keq i kena sfiduar. U ardh për shembull babai i një dëshmorit ka hy në votim të fsheht dhe nuk e kanë votuar. Janë lënduar familjet për mos me u lënduar. As ju as familjet unë s'kam pranuar, të shkohet në këtë formë. Por po e marrë si obligim me e nda atë mirënjohje se është i merituar z. Ukshin Maloku.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titull “Nderi i qytetit” i Komunës së Vushtrrisë, nderohet z. Nesim Ispahiu, për kontributin e dhënë për qytetin e Vushtrrisë.

2. Dorëzimi i kësaj dekorate (titulli) do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Propozim-vendimi për dhënien e çmimit “Emblema e Vushtrrisë”;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin “Emblema e Vushtrrisë“, nderohen z. Januz Halili për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

2. Dorëzimi i çmimit do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2026, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Pyetje dhe përgjigje.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-përseriti pyetjen saj edhe njëherë duke rishikuar, ku dhe sa është ndarë sipërfaqja e dhënë për ndërtimin e banesave sociale se këtë nuk e kam si informatë që të paktën të dimë se ku gjendemi me këtë proces.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se pyetja e tij konkrete do të ishte për Drejtoreshën e Arsimit. Po pasi që s'është drejtoresha e arsimit këtu, po e shoh që është kryetari. Po e shoh këto ditë që po organizohen shëtitje një ditë nga ana e shkollave. Konkretisht e kam fjalën për shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Migjeni”, Stanoc i Epërm. Ata sot e kanë një shëtitje një ditore me klasë e shtatë, teta dhe të nënta. Kurse prej klasës së parë deri në klasën e shtatë sot fare nuk janë duke mbajtur mësim. E dimë që kalendarin për vitin shkollor e harton dhe e miraton Ministria e Arsimit. Nuk e di a ju kanë marrë në një farë forme leje Drejtoreshës Arsimit a kryetarit të komunës apo drejtoria e shkollës “Migjeni” do ta kompensojë ditën e humbur për nxënësit të cilët sot ata janë në shëtitje pra nga klasë e nënta kurse nxënësit të tjerë janë në shtëpi përfshij edhe fëmijët e mi.

Ramadan, Parduzi, anëtar i kuvendit- pyeti kryetarin e komunës tek shkolla SHMU1, a ka mundësi të ngritet një kompleks sportiv për nevojat e nxënësve dhe qytetarëve.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-njoftoi se lokacioni për ndërtimin e banesave sociale është ndarë apo është caktuar tek objekti i Qendrës së Mjekësisë Familjare. Saktisht aty ku po propozohet kompleksi sportiv nga z. Ramadan Parduzi, kjo për arsye se ajo ka qenë pronë e komunës. Me thënë të drejtën unë e pata propozuar te kjo Qendra e të Moshuarve në atë parcelë, po meqë kjo domethënë është me fletë-poseduese është pronë e AKP-së atëherë ministria tha ne investojmë vetëm në prona komunale. Pronë komunale patëm aty dhe ato i kemi dhënë për ngritjen e kompleksit të banesave sociale. Sa i përket pyetjes së z.Ymer Haradinaj ceku se nuk është në dijeni për këto po të premtoj që menjëherë nesër kam me intervenuar për këtë rast nuk kanë të drejtë me ndërpre procesin mësimor. Sipas Udhëzimi Administrativ për vizita dhe erskusione edhe brenda komunës edhe jashtë komunës edhe tash do të shikojmë nëse dikush e ka marrë në përgjithësi të vete ka me marrë në përgjegjësi të vete edhe masat disiplinore që janë të parapë sipas

legjislacionit në fuqi. Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Ramadan Parduzy, për kompleksin sportiv ceku se ajo pronë është ajo parcelë është e dedikuar për banesa të banimit të qëndrueshëm që jemi në bashkëpunim me ministrinë adekuate. Por, sa i përket atij kompleksi, hajde gjatë hartimit të buxhetit për vitet e ardhshme se ai s'bëhet veç për 2027, po më duket është 2027/2028. I shikojmë parcelat, të dimë idenë çka sa po duam, qysh je i fushës adekuate edhe e marrim, e vendosim e promovjmë që është domethënë një produkt, një propozim i mirë dhe mund ta zhvillojmë si projekt të përbashkët.

Mbledhja përfundoj në ora 14:10

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	15.06.2026
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES;	Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës _____
NGA/OD/FROM;	Abit Abiti, ZKF _____
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/01, e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe po e dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument është dokumenti bazë për planifikimin e buxhetit Komunal, përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 është në përputhje me udhëzimet e dhëna me Qarkoren Buxhetore 2027/01 të nxjerra nga Ministria e Financave .

Shtojcë :

- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	15.06.2026
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES;	Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës _____
NGA/OD/FROM;	Abit Abiti, ZKF _____
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/01, e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe po e dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument është dokumenti bazë për planifikimin e buxhetit Komunal, përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 është në përputhje me udhëzimet e dhëna me Qarkoren Buxhetore 2027/01 të nxjerra nga Ministria e Financave .

Shtojcë :

- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve



KOMUNA VUSHTRI

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
2027-2029**

KOMUNA E VUSHTRRISË

Përmbajtja

Hyrja.....	2
Prioritet strategjike.....	2
Ekonomia lokale.....	3
Swot analiza.....	4
Vizioni i Komunës.....	5
Misioni i Komunës.....	5
Prioritetet e Komunës.....	6
Korniza fiskale komunale – Të hyrat.....	7
Burimet e Financimit Komunal për vitin 2027-2029.....	8
Granti i Përgjithshëm për vitin 2027.....	10
Granti specifik për Arsim para universitar për vitin 2027.....	11
Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2027.....	11
Të hyrat vetanake komunale për vitin 2027 dhe parashikimet 2027-2029.....	12
Donatorët e jashtëm (ndërkombëtar).....	15
Shpenzimet Afatmesme Komunale – Korniza buxhetore.....	16
Plani i zhvillimit kapital.....	23

Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)2027 - 2029 parqet dokumentin strategjik mbi bazën e të cilit planifikohet buxheti për vitin 2027 dhe projeksioni për dy vitet e ardhshme. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave në dispozicion të Komunës dhe në bazë të këtyre të hyrave planifikohen shpenzimet publike. Shpenzimet e planifikuara pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-së është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Komunale të Buxhetit 2027/01 të lëshuar nga Ministria e Financave me datë 15.05.2026.

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)2027 – 2029 është bazuar në dokumentet Strategjike të zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, dokumente të cilat ofrojnë një kornizë për programin e zhvillimit ekonomik për të drejtuar komunitetin e qytetarëve në Vushtri në drejtimin e objektivave strategjike.

KAB paraqet një planifikim afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Perspektivë afatmesme e planifikimit buxhetor – 3 vjeçar
- Ndërlidhja e prioritetëve të politikave me ndarjen e mjeteve, d.m.th. me buxhetin
- Theksimi i shfrytëzimit efikas të burimeve të kufizuara publike (si atyre kapitale ashtu edhe atyre operative)

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave në dispozicion
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultate
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caceve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2027-2029.

KAB do të përditësohet pas miratimit të buxhetit vjetor komunal (2027) nga Kuvendi i Komunës dhe të rishikohet pas 12 muajsh si pjesë procesit përgatitor të buxhetit vjetor.

Prioritetet strategjike të Komunës

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34 km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:

X1 : 200 50' 09" dhe X2 : 210 07' 05";
Y1 : 420 42' 20" dhe Y2 : 420 55' 12".

Vërejtje: KAB 2027-29 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2027 nga Kuvendi Komunal

Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me sipërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km².

Ekonomia lokale

Në komunën e Vushtrrisë operojnë rreth 2,412 biznese. Numri më i madhe i këtyre bizneseve janë të orientuar në veprimtari tregtare. Duke u bazuar në të dhënat Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rreth 37.48 % e bizneseve merren me tregti, 16.79% me transport dhe telekomunikacion, 10.12 % hynë shërbimet hoteliere, restorantet, përgatitja e ushqimit etj. Agrobiznesi është me i zhvilluari dhe akoma një sektor premtues për zhvillimin e ardhshëm të Vushtrrisë, kryesisht Komuna jonë prinë në prodhimin e patates, përpunimi i patates, “Vipa Chips” zën vend të rëndësishëm në ekonominë e Komunës. Gjithashtu edhe industria e përpunimit të drurit është mjaft e zhvilluar si fabrikat ” Bini”, “Berto” etj. Duhet të ceket se nga ky numër i bizneseve vetëm 1,604 janë aktive.

	Veprimtarit ekonomike	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria	148	6.14
2	Peshkimi	2	0.08
3	Industria nxjerrëse	15	0.62
4	Industria përpunuese	203	8.42
5	Prodhi me energji elektrike, gaz, ujë, avull, ujë të ngrohtë	4	0.17
6	Ndërtimtaria	154	6.38
7	Treg. me shumice dhe pakice, rip. i auto dhe aparateve tjera të amvisëri	904	37.48
8	Hotelet dhe Restorantet	244	10.12
9	Transporti, depot dhe telekomunikacion	405	16.79
10	Aktivite financiare	3	0.12
11	Afarizmi me pasurit e patundshme	95	3.94
12	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	3	0.12
13	Arsimi	27	1.12
14	Shëndetësia	47	1.95
15	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	158	6.55
	Totali	2,412	100

Vërejtje: KAB 2027-29 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2027 nga Kuvendi Komunal

SWOT ANALIZA

Vushtrria, si shumica e komunave në Kosovë, ballafaqohet me sfida të ndryshme zhvillimore, por njëkohësisht, për shkak të pozicionit gjeografik dhe potencialeve që ka, është edhe rast i mundë- sive për zhvillim të qëndrueshëm në sferën ekonomike, administrative dhe sociale. Në këtë drejtim analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve paraqet një faktor të rëndësishëm për të determinuar objektivat strategjike të komunës në pesë vitet e ardhshme.

Përparësitë • Pozita e volitshme gjeografike • Distanca rrugore e Vushtrrisë nga kryeqendra e Kosovës-Prishtina 25 km, nga Mitrovica 10 km • Resurset natyrore • Toka pjellore për bujqësi Rrjedha e lumit Silnica • Sipërfaqe të mjaftueshme të tokës • Tradita bujqësore dhe agro-industriale • Prodhimi cilësor i farës së patates • Niveli i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) • Zhvillimi i industrisë agrikulturore • Burimet natyrore të pranishme në disa lokacione në këtë zonë • Infrastruktura relativisht e mirë • Popullsia me prirje për zhvillim të ekonomisë së vogël • Sistemi i ujitjes • Ambient i mirë për blegtori	Dobësitë • Mosshfrytëzimi i tokës bujqësore në masë të duhur • Ndotja mjedisore prezente • Menaxhimi joadekuat mjedisor • Shërbimet shëndetësore jo të mjaftueshme- implementimi jo i plotë i konceptit të mjekësisë familjare • Furnizimi jostabil me energji • Të dhënat e kufizuara në të gjithë sektorët ekonomikë • Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme për sektorin privat • Qasja e kufizuar në kapital. • Sistemi arsimor jokompatibil me kërkesat e tregut të punës. • Infrastruktura jo e mjaftueshme për aktivitete kulturore, rini dhe sport
Mundësitë • Bujqësia – zhvillimi i produkteve lokale • Përmirësimi i infrastrukturës së biznesit– p.sh. inkubatorët, parqet e biznesit dhe zonat industriale • Kthimi i fondeve financiare nga jashtë, • Përfshirja e diasporës në identifikimin e tregjeve globale për produktet e Vushtrrisë- Kosovës dhe promovimin e tyre • Mjedisi – adaptimi i planeve urbane, rehabilitimi i zonave të degraduara, ripyllëzimi, riciklimi i mbeturinave, krijimi i një plani për trajtimin e ujit të ndotur • Burimet alternative të energjisë • Industria agrikulturore dhe prodhuese • Investimet e jashtme dhe lokale • Turizmi – zhvillimi i turizmit rural • Burimet njerëzore: Ngritja e kapacitetit profesional njerëzor	Rreziqet • Buxhetet e limituara komunale; • Inkasimi jo i kënaqshëm i të hyrave vetanake komunale; • Mos-implementimi i strategjive ekzistuese për zhvillim ekonomik lokal; • Mos funksionalizimi i ndërmarrjeve të privatizuara; • Zvogëlimi i interesimit të donatorëve për investime; • Mungesa e investimeve dhe mirëmbajtja e tyre në infrastrukturën publike lokale;

Vërejtje: KAB 2027-29 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2027 nga Kuvendi Komunal

VIZIONI I KOMUNËS

Rajoni i Vushtrisë ka potencial rinor i cili kërkon arsim cilësor, mbështetje të punësimit përmes rritjes së investimeve dhe mbështetjes së sektorit privat, krijim të klimës së favorshme për të zhvilluar biznes, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët. Përmes zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal, për të krijuar mundësi të barabarta dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, të matur me infrastrukturë cilësore, mjedis të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të cilat janë në pajtim me standardet e BE-së. Në pesë vitet e ardhshme vizioni i Vushtrisë është që të jetë komunë me rritje të lartë ekonomike dhe nivel të ulët të papunësisë në Kosovë, me administratë moderne komunale dhe arsim të nivelit evropian.

MISIONI I KOMUNËS

Komuna e Vushtrisë do të zhvillojë dhe do të ngrisë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, do të sigurojë një jetë me të mirë për të gjithë qytetarët e saj nëpërmjet këtyre shtyllave:

- Zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik
- Avancimit të arsimit dhe edukimit
- Përmirësimit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Zhvillimit të infrastrukturës dhe ruajtjes së ambientit
- Promovimit të turizmit, kulturës dhe sportit
- Rritjes së efikasitetit të administratës publike

PRIORITETET E KOMUNËS

Prioriteti 1

Mbështetja e zhvillimit ekonomik të planifikuar me sisteme infrastrukturash publike të ndërtuara në nivele që adresojnë nevojat dhe i paraprijnë zhvillimit të veprimtarive private e publike cilësore.

Prioriteti 2

Shndërrimi i Vushtrisë në një zonë ku bizneset ruhen, rriten e zhvillohen në sektorët e prodhimit, përpunimit e tregtimit të produkteve, kryesisht tradicionale dhe ku mundësitë dhe burimet shfrytëzohen në mënyrë racionale për të nxitur shërbime cilësore dhe turizëm.

Prioriteti 3

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 29.05.2026 - 14:34
Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Grace / Grace / Keshijellë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA						
Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On
P-70202022-00512-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		53693		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SELISHTE/VISHE KOKOTA	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klase/5th Class Arable Land	53693

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrisë	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Drejtoria për Shërbime Publike

DATË:	15.06.2026
PËR:	Kuvendin e Komunës
PROPOZUES:	Ferit Idrizi  Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
HARTUES:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
TEMA:	Akt – përcjellës

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Ky dokument është hartuar nga komisioni i themeluar me vendimin nr. 5767/26 të datës 06.02.2026 të kryetarit të komunës dhe i njëjti i ka kaluar të gjitha filtrat ligjor, duke përfshirë edhe diskutimin publik nga data 10.03.2026 deri më 26.03.2026.

Konsultimi publik është mbajtur me datën 23.04.2026 dhe nuk kemi pranuar vërejtje dhe sugjerime përmbajtësore nga pjesëmarrësit.

Duke konsideruar se ky dokument i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të njëjtën po ua procedojmë për shqyrtim në KPF dhe të njëjtën për aprovim nga Kuvendi i Komunës.

Me respekt!



Në mbështetje të nenit 12.2 pika c, nenit 17, pika f, nenit 40.2, pika a dhe g, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19.1, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.06.2008, neni 15 dhe 34 të Ligjit Nr. 04/L – 60 për Mbeturina i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 29.06.2012, Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.09.2022 dhe nenit 13 nën par. 1.6, nenit 18 nën par. 1.1 të Statutit Nr. 209/22 të Komunës së Vushtrrisë të miratuar me datë 06.09.2022 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me __. __. 2026, miratoi këtë:

DRAFT – RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Kjo rregullore përshkruan përmbajtjen dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në lidhje me shërbimin publik të mbledhjes së mbeturinave komunale, komerciale dhe jo vetëm, mënyrën dhe kushtet e përcaktimit të tarifës për pagesën e mbeturinave komunale për amvisëri dhe biznese.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, si dhe përcakton vlerën (shumën) e tarifës për mbeturina, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar me cilësi të lartë, dhe ekonomikisht të efektshëm të mbledhjes së mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e interesit publik.
2. Me këtë rregullore përcaktohet sistemi, mënyra e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, llojin, mënyrën e shpërndarjes dhe të vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku bëhet mbledhja e mbeturinave dhe transportimi i tyre.

Neni 3 **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore definon kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave për të zvogëluar sasinë që deponohet, shkarkimin, grumbullimin, transportimin dhe deponimin. Gjithashtu në kuadër të fushë veprimtarisë bënë pjesë edhe ndarja dhe aktivitetet e riciklimit, me qëllim të ruajtjes (mbrojtjes) së mjedisit jetësor në tërë territorin e Komunës së Vushtrisë.

Neni 4 **Përkufizimet**

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë domethënie:

- 1.1 Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi - zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh ose është i detyruar ta hedh.
- 1.2 Menaxhimi i mbeturinave** – (në tekstin e mëtejshëm i referohemi MM), aktivitetet për evitimin, reduktimin e prodhimit të mbeturinave, ndikimit të tyre në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së tyre.
- 1.3 Operatori** – nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 1.4 Ndërmarrja** – nënkupton N.P.L “Përparimi” Sh. A.
- 1.5 Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- 1.6 Person** - person fizik ose juridik i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 1.7 Konsumatori** – person fizik dhe juridik të cilëve u ofrohen shërbime për mbeturinat.
- 1.8 Ri-përdorimi** – përdorim i serishëm përmes së cilit çdo produkt apo komponentë e cila nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim.
- 1.9 Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
- 1.10 Mbledhja** – grumbullim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 1.11 Mbledhja e selektuar** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet

në mënyrë të ndare në lloje, të klasifikuara sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

- 1.12 Gjenerues i mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose operime tjera të cilat rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 1.13 Zotëruesi i mbeturinës** - gjeneruesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
- 1.14 Ekonomitë familjare rezidente** - Ekonomitë familjare rezidente - njësitë familjare që banojnë në mënyrë të përhershme në një objekt banesor brenda territorit të komunës dhe që gjeneron mbeturina komunale në mënyrë të rregullt duke qenë subjekt i shërbimeve të mbledhjes dhe pagesës së tarifës për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave.
- 1.15 Ekonomitë familjare jorezidente** - njësi familjare që nuk banon në mënyrë të përhershme në një objekt banesor brenda territorit të komunës, por e përdorë atë në mënyrë të përkohshme ose sezonale. Duke gjeneruar mbeturina komunale vetëm gjatë shfrytëzimit të objektit.
- 1.16 Ekonomitë familjare pasive** - njësi familjare ose objekt banesor që nuk është i banuar dhe që nuk gjeneron mbeturinë komunale.
- 1.17 Mbeturina komunale** - nënkupton: mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet; mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake, dhe mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 1.18 Bio-mbeturina** - nënkupton mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbeturinat ushqimore dhe të kuzhinës nga amvisëritë, zyrat, restorantet, shitësit me shumicë, mensat etj.
- 1.19 Mbeturina e parrezikshme** - mbeturina që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe nuk kanë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 1.20 Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, si dhe çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi.
- 1.21 Mbeturina inerte** - mbeturina të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si mbeturinat që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut, ku i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës (mbetjet ekotoksike) duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave

sipërfaqësore dhe nëntokësore.

1.22 Mbeturinë e vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

1.23 Mbeturina ndërtimi dhe rrënimi – nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes.

1.24 Kontratë për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale – nënkupton kontratën në të cilën mbledhësi i mbeturinave bën mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komerciale për llogari të gjeneruesit të mbeturinave

1.25 Faturë – nënkupton një dokument i besueshëm i cili i dërgohet debitorit për përmbushjen e detyrimit nga ana e tij.

1.26 Qendra grumbulluese – Lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të tyre.

1.27 (3R) – reduktim, ripërdorim, riciklim

1.28 Gjinia – fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

1.29 Njëjës/shumës - njëjësi do të nënkuptojë shumësin dhe anasjelltas.

Neni 5

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

1. Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave bëhet nga personi i pajisur me leje mjedisore komunale dhe i kontraktuar nga komuna, prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave.
2. Mbeturinat e rrezikshme, para se të mblidhen dhe transportohen, klasifikohen sipas llojeve të tyre, pastaj mblidhen dhe transportohen.
3. Nëse gjatë transportimit të mbeturinave ndodhë ndotja, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.

Neni 6

Menaxhimi i mbeturinave nga Komuna

1. Përgjegjësitë e Komunës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë:
 - 1.1 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
 - 1.2 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
 - 1.3 Kontraktimi i shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit përkatës të prokurimit, përzgjedh operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore për secilin shërbim veçmas, apo si tërësi në lidhje me mbledhjen, grumbullimin, magazinimin e mbeturinave, transportimin e mbeturinave komunale, komerciale dhe të gjitha llojet e tjera të mbeturinave.
 - 1.4 Formimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- 1.5 Monitorimi dhe udhëzimi për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave bëhet nga Sektori për menaxhimin e mbeturinave.
- 1.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të qendrës së paketimit të mbeturinave të riciklueshme, e cila është ndërtuar në fshatin Bukosh.
- 1.7 Të bëjë identifikimin dhe nëpërmjet operatorëve ekonomik largimin e deponive ilegale të mbeturinave.
- 1.8 Përcaktimi i vendndodhjes të vendosjes së kontejnerit dhe llojit të kontejnerëve që do të shfrytëzohet në bashkëpunim me operatorin ekonomik dhe palët e treta.
- 1.9 Promovimi i reduktimit të sasisë së mbeturinave (përmes metodave të 3R, ndarjes në burim dhe kompostimit shtëpiak).
- 1.10 Ngritja e vetëdijes publike - pjesëmarrja aktive e qytetarëve në zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave.
- 1.11 Planifikimi buxhetor për funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 1.12 Përcaktimi i tarifës dhe mënyrës së arkëtimit të mjeteve financiare caktohet me këtë rregullore.
- 1.13 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave çdo 31 mars të vitit pasues.
- 1.14 Sigurimi i kushteve të barabarta për veprim për operatorët publik dhe privat, mirëpo që operatori ekonomik publik në pajtim me nenin 9 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ka përparësi, e që rast përjashtim mund të jetë ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme kur operatori ekonomik publik nuk mund të ofrojë shërbim, mund të vie në shprehje të kontraktohet një operator privat i pajisur me leje mjedisore përkatëse. Pajisë me leje mjedisore komunale, operatorët që merren vetëm me bartjen dhe transportimin e mbeturinave komunale.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

1. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtë të kërkojë që t'i bëhet zbrazja e kontejnerit.
2. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtë të kërkojë që me rastin e zbrazjes së kontejnerit nga operatori i kontraktuar të bëjë edhe dezinfektimin e të njëjtit së paku gjashtë (6) herë në muaj, dhe të bëjë pastrimin e hapësirës përreth kontejnerit.
3. Gjeneruesi i mbeturinave ka të drejtën e parashtrimit të ankesës në rastet kur nuk bëhet mbledhja e mbeturinave që ai gjeneron.
4. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe ka të drejtë qasjeje në shërbimin e ofruar.
5. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të paguajë për shërbimin që pranon tarifën e përcaktuar në shtojcën e kësaj rregulloreje, dhe gjeneruesi paguan në bazë të parimit "Ndotësi Pagan".
6. Gjeneruesi i mbeturinave duhet t'i mundësojë qasje operatorit në vendin e dorëzimit të

mbeturinave.

7. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuara sipas planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.
8. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të bëjë hedhjen e mbeturinave në vende të caktuar nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave.
9. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave.
10. Gjeneruesi i mbeturinave duhet të paraqes ndryshimin e të dhënave (siç janë: shitja e pronës, trashëgimia dhe dëshmitë tjera relevante).
11. Regjistrimet e reja të amvisërive në sistem bëhen në bazë të këtyre kritereve:
 - 11.1 Para kontrata dhe kontrata e shitblerjes.
 - 11.2 Blerësi duhet të regjistrohet në sistem, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa shitësit vetëm adresa i ndryshohet.
 - 11.3 Regjistrimi i njehsorit të rrymës elektrike.
 - 11.4 Konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina për vendbanimin paraprak.
 - 11.5 Dokumenti identifikues.
12. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.
13. Gjeneruesi i mbeturinave, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.
14. Gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të regjistrohet në listat e shërbimit të gjeneruesve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
15. Gjeneruesi i mbeturinave detyrohet që mbeturinat t'i ndajë dhe t'i vendos sipas sistemit të përcaktuar në planin e operimit të përcaktuar nga komuna.
16. Ndërmarrjet prodhuese, ndërtuese dhe tjera në cilësinë e gjeneruesve të mbeturinave, obligohen që Komunës së Vushtrrisë, t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 8

Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave

1. Sistemit të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë i nënshtrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që banojnë, veprojnë ose posedojnë pronë të paluajtshme në territorin e Komunës.
2. Detyrimi për pagesën e tarifës së mbeturinave lind nga momenti i ofrimit të shërbimit në zonën kadastrale përkatëse, nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve, dhe hedhjes së mbeturinave nga gjeneruesit e mbeturinave.
3. Mungesa e një kontrate të shkruar individuale ndërmjet gjeneruesit të mbeturinave dhe operatorit nuk e liron gjeneruesin nga detyrimi për pagesën e tarifës mujore të miratuar nga Kuvendi Komunal.
4. Ky detyrim rrjedh nga neni 13 dhe neni 34 par. 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.
5. Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

5.1 Kategoritë e amvisërive ndahen në nën kategoritë si në vijim:

5.1.1 Familjet rezidente;

5.1.2 Familjet jo rezidente nga diaspora;

5.2 Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga bizneset të ndarë në nën kategoritë si në vijim:

5.2.1 Nënkatëgoria e parë - përfshinë veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese me pagesë mujore në vlerë prej 10.00 €. Kjo nënkategori përfshinë: kioskat dhe shitoret e dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave; shitoret e dyqanet e vogla si shitësit e kafesë, disqeve, kozmetikës, syzeve, thjerrëzave dhe suvenireve (dhuratave) të vogla, axhustatorët (salduesit), argjendaritë, orëtarët, agjencitë turistike, rrobaqepësit, këpucëtarët, fotografët, butikët, libraritë, dyqanet e pastrimit kimik, këmbimoret, llamarinë-punuesit, zyrat e shërbimeve profesionale deri në 20m², siç janë zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbaruesve, këshilltarëve financiarë; veprimtaritë e tjera të vogla siç janë parkingjet, qendrat e video-lojërave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjisë, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.2 Nënkatëgoria e dytë - përfshinë subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale dhe industriale me kosto të ulët të shërbimit siç janë: lokalet për shitjen e mjeteve motorike (auto sallonet) dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përfshirë limarët), frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal, barnatoret, ordinancat, klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karrige (për mbeturina komunale), serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike, sallonet e sanitarisë, qendrat e fitnesit, shitoret e vogla përfshirë shitoret sanitare, të mobileve, të auto-pjesëve, të tekstilit dhe këpucëve; ndërmarrjet publike, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.3 Nënkatëgoria e tretë - përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit siç janë: kafiteritë dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë, shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve, zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi mbi 20m², siç janë zyrat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, bankat, këshilltarëve financiarë, sallonet e mëdha të mobilie, qendrat sportive, veprimtaritë zejtare më të rënda si limarët dhe xhamaprerësit; spitalet (vetëm sa i përket mbeturinave komunale), pompat e benzinës me mini-market, ndërmarrjet publike, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.4 Nënkatëgoria e katërt - përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale industriale me kosto të lartë të shërbimit siç janë: dyqanet e mëdha (super marketet) dhe furrat e bukës dhe byrektoret, restorantet (për ahengje familjare, salla dasmesh etj.), gjellëtoreset, klubet e natës, veprimtaritë hoteliere, pompat e benzinës me restorant, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.2.5 Nënkatëgoria e pestë - përfshin subjektet ekonomike dhe komerciale që ushtrojnë veprimtari të specializuar në trajtimin, përpunimin, si dhe shitjen me shumicë ose pakicë të mishit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë: mishoret, pikat e specializuara të shitjes së mishit, njësitë e përpunimit dhe paketimit që hudhin eshtrat.

5.3 Kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave që rrjedhin nga institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera:

5.3.1 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit që përfshinë: Zyrën e Punësimit, Agjencioni për Regjistrim Civil, Ambulantet e Mjekësisë familjare, Qendra për Punë Sociale, Zyrat e Partive Politike, dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.3.2 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme të shërbimit që përfshinë: Shkollat fillore dhe të mesme, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare, Spitali Regjional Sheikh Zayed sa i përket mbeturinave komunale, Halla e Sporteve – Jeton Tërstena – Tota, Stadiumi i Futbollit – Ferki Aliu, Stadiumi i Futbollit në fsh. Doberlluke, Fakulteti i Sigurisë Publike, Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri, dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

5.3.3 Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit që përfshinë: Akademia për Siguri Publike, Stacionet Policore, Qendra korrektuese në Smrekonicë dhe institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

6. Tarifat e përcaktuara në lidhje me kategorizimet e lart cekura gjenden nënin 9 të kësaj rregulloreje.
7. Operatori ekonomik duhet të bëjë lidhjen e kontratave individuale me kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave të cekura në par. 5 të këtij neni, por që të gjithë gjeneruesit e mbeturinave vlen par. 3 i këtij neni.

Neni 9

Tarifa për mbeturina

1. Tarifa për mbeturina, faturohet dhe inkasohet si në vijim:
 - 1.1 Tarifën për mbeturina e cakton komuna me anë të kësaj rregulloreje;
 - 1.2 Faturimin dhe inkasimin si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për bizneset, institucionet publike, OJQ-të dhe institucionet e tjera e bën ndërmarrja.
2. Tarifa për ekonomitë familjare rezidente caktohet si në vijim:
 - 2.1 Ekonomitë familjare rezidente do të paguajnë shumën në vlerë prej 10.00€ në muaj.
 - 2.2 Ekonomitë familjare jo rezidente do të paguajnë shumën në vlerë prej 40.00€ në vit.
3. Tarifa për bizneset, institucionet publike, OJQ-të dhe institucione të tjera do të përcaktohen si në vijim:
 - 3.1 Nënkatëgoria e parë që përfshinë veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do të ngarkohet prej 10.00€ në muaj.

- 3.2 Nënkatëgoria e dytë që përfshinë subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale dhe industriale me kosto të ulët të shërbimit do të ngarkohet në shumën në vlerë prej 20.00€ në muaj.
- 3.3 Nënkatëgoria e tretë që përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit, do të ngarkohet në shumën në vlerë prej 25.00€ për muaj.
- 3.4 Nënkatëgoria e katërt që përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale industriale me kosto të lartë të shërbimit do të ngarkohet si në vijim:
 - 3.4.1 Për zbrazjen e kontejnerit 1.1 m³ në vlerë prej 14.00€.
 - 3.4.1.1 Bizneset me më shumë se një zbrazje të kontejnerëve 1.1 faturohen me 10.00 euro për çdo zbrazje tjetër.
 - 3.4.2 Për zbrazjen e kontejnerit 5m³ në vlerë prej 60.00€.
 - 3.4.3 Për zbrazjen e kontejnerit 7 m³ në vlerë prej 75.00€.
 - 3.4.4 Për asgjësimin e eshtrave do të paguhet shuma në vlerë prej 200.00€ për një muaj.
- 3.5 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit do të ngarkohen në shumën në vlerë prej 10.00€ në muaj.
- 3.6 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të mesëm të shërbimit do të ngarkohen në shumën në vlerë prej 20.00€ në muaj.
- 3.7 Institucionet publike, OJQ – të dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit do të ngarkohen si në vijim:
 - 3.7.1 Për zbrazjen e kontejnerit 1.1 m³ në vlerë prej 14.00€.
 - 3.7.2 Për zbrazjen e kontejnerit 7 m³ në vlerë prej 75.00€.
4. Shpërndarja e faturës së mbeturinave bëhet duke u bazuar në sistemin e të dhënave që ka komuna, ku gjeneruesve të mbeturinave do t'u dorëzohet fatura muaj për muaj.
5. Dorëzimi i faturave bëhet në pajtueshmëri me nenin 109 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku dorëzimi do të bëhet përmes postës elektronike apo fizike.
6. Pagesa e tarifës për mbeturina mund të bëhet në arkën e komunës në Qendrën e Shërbimit me Qytetar, ose në institucionet financiare për pagesa, apo në vende të tjera të caktuar nga ana e ndërmarrjes.
7. Gjeneruesit mund të parapagujnë tarifën për gjashtë (6) muaj ose një (1) vit.
8. Secili gjenerues që banon me qira, është i obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emër personal dhe duhet të regjistrohet në sistemin për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar (në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit).
9. Në rast se gjeneruesi i mbeturinave nuk i përmbush obligimet financiare për shërbimet e ofruara brenda afateve të përcaktuara, ofruesi i shërbimit ka të drejtë të iniciojë procedurat e detyrueshme të arkëtimit të borxhit përmes Përmbaruesit Privat.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e operatorit të kontraktuar për shërbimin e mbeturinave

Operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për mbledhjen, transportimin, grumbullimin, riciklimin dhe shërbime të tjera që përfshihen në kuadër të menaxhimit të mbeturinave, janë të obliguar që të veprojnë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi, të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Neni 11

Veprimet e ndaluara

1. Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

- 1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;
- 1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë me legjislacionin në fuqi dhe aktet tjera relevante të kësaj fushe;
- 1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv siç janë; ballkonet, korridoret dhe tarracat e banesave;
- 1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
- 1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
- 1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike si në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike;
- 1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të përcaktuara për hedhjen e mbeturinave, pa autorizim të autoriteteve komunale dhe ndërmarrjes.
- 1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, në pikat mbledhëse dhe ndarëse të mbeturinave;
- 1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët dhe të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”, për të cilët ekzistojnë kontejner dhe kontrata të veçanta;
- 1.11 Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
- 1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 1.13 Dërdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve, gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 1.14 Ndalimi i transportimit të mbeturinave, pa mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportimit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
- 1.15 Ndalohet ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të

mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë.

1.16 Ndalohet hedhja në kontejnerë ose në afërsi të tyre të mbeturinave nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme.

Neni 12

Dispozitat Ndëshkuese

Ndaj çdo personi fizik ose juridik që ndërmerr veprime me të cilat ndotet mjedisi apo bën shkelje të tjera të parapara me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe plotësim-ndryshimet e tij (Ligji Nr. 08/L-071), do të shqiptohet gjobë mandatare ose do të iniciohet procedurë për kundërvajtje në Gjykatë nga Inspektorët Komunalë ose Policia e Kosovës, konform lartësisë dhe procedurave të përcaktuara në Dispozitat Ndëshkimore të Ligjit në fuqi.

Neni 13

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe shtojca e cila bënë kategorizimin dhe përcaktimin e taksave.
2. Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje ngarkohen dhe autorizohen ekze: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektime, si dhe Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" Sh.A. në Vushtrri, secila në bazë të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe me këtë akt.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (KKV) Nr. 05/2020 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë dhe Rregulloren (KKV) Nr. 03/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesues/e i/e Kuvendit Komunal
të Vushtrrisë**



SHTOJCA E RREGULLORES

Nën kategoria e parë – Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese me pagesë mujore në vlerë prej: 10.00 €uro	Nënkategoria e dytë – Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 15.00 – 20.00€uro	Nënkategoria e tretë - Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të moderuar të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 25.00€uro	Nënkategoria e katërt - Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej: 14.00€ për zbrazje të kontejnerit 1.1m ³ , në vlerë prej 50.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 5m ³ , dhe në vlerë prej prej 75.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 7m ³	Nënkategoria e pestë Subjektet ekonomike dhe komerciale që ushtrojnë veprimtari të specializuar në trajtimin, përpunimin, si dhe shitjen me shumicë ose pakicë të mishit me pagesë mujore në vlerë prej 200.00€
Kioskat dhe shitoret e dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave	Lokalet për shitjen e mjeteve motorike (auto sallonet) dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përfshirë limarët)	Kafiteritë dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë	Dyqanet e mëdha (super marketet) dhe furrat e bukës dhe byrektorët	Mishoret, pikat e specializuara të shitjes së mishit, njësitë e përpunimit dhe paketimit që hudson eshtrat.
Shitoret e dyqanet e vogla si: shitësit e kafesë,	Frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal	Shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve	Restorantet (për ahengje familjare, salla dasmash etj.)	

disqeve, kozmetikës, syzeve, thjerrëzave dhe suvenireve (dhuratave) të vogla	Barnatoret			
Axhustatorët (salduesit)		Zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi mbi 20m ² , siç janë: zyrat e avokatëve, noterëve, përmbauesve, këshilltarëve financiarë, dhe bankat	Gjellëtorët	
Argjendaritë	Ordinancat	Sallonet e mëdha të mobiliave	Klubet e natës	
Orëtarët	Klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karige (për mbeturina komunale)	Qendrat sportive	Veprimtaritë hoteliere	
Agjencitë Turistike	Serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike	Veprimtaritë zejtare më të rënda si limarët dhe xhamaprerësit	Pompat e benzinës me restorant	
Rrobaqepësit	Shitoret e tekstilit	Spitalet (vetëm sa i përket mbeturinave komunale)	Veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	
Këpucëtarët	Sallonet e sanitarisë	Pompat e benzinës me mini-market		
Fotografët	Qendrat e fitnesit	Ndërmarrjet Publike		
Butikët	Shitoret e vogla përfshirë shitoret sanitare, të mobileve, të auto-pjesëve	Veprimtari të tjera të ngjashme për nga		

		madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë
Libraritë	Shitoret e kypucwve	
Dyqanet e pastrimit kimik	Veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	
Këmbimoret		
Llamarinë-punuesit		
Zyrat e shërbimeve profesionale deri në 20m ² , siç janë: zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbauesve, këshilltarëve financiarë		
Veprimtari të tjera të vogla siç janë: parkingjet, qendrat e video-lojërave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjisë		
Veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë		

Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 10.00Euro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 20.00Euro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej 14.00Euro për zbrazje të kontejnerit 1.1m ³ dhe në vlerë prej 75.00Euro për zbrazje të kontejnerit 7m ³
Zyrën e Punësimit	Shkollat fillore dhe të mesme Korrik - Gusht	Akademia për Siguri Publike
Agjencioni për Regjistrim Civil	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare	Stacionet Policore
Ambulantet e Mjekësisë familjare	Spitali Regjional Sheikh Zayed – sa i përket mbeturinave komunale	Qendra korrektuese në Smrekonicë
Qendra për Punë Sociale	Halla e Sporteve – Jeton Tërstena – Tota	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
Zyrat e Partive Politike	Stadiumi i Futbollit – Ferki Aliu	Shkollat fillore dhe të mesme Shtator - Qershor
Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	Stadiumi i Futbollit në fsh. Doberllukë	
	Fakulteti i Sigurisë Publike	
	Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri	
	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	